



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.155

25 nëntor

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 476 datë 3.11.2011	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e konventës së vitit 1979 “Për ndotjen ndërkuftare të ajrit në distancë të largët, për të pakësuar acidifikimin, eutrofikimin dhe ozonin në shtresën e poshtme të atmosferës”.....	7429
Vendim i KM nr.781, datë 10.11.2011	Për licencimin e shkollës së lartë universitare private “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, Tiranë.....	7482

LIGJ
Nr.10 476, datë 3.11.2011

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN E KONVENTËS
SË VITIT 1979 “PËR NDOTJEN NDËRKUFITARE TË AJRIT NË DISTANCË TË
LARGËT, PËR TË PAKËSUAR ACIDIFIKIMIN, EUTROFIKIMIN DHE OZONIN NË
SHTRESËN E POSHTME TË ATMOSFERËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin e konventës së vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët, për të pakësuar acidifikimin, eutrofikimin dhe ozonin në shtresën e poshtme të atmosferës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7159, datë 15.11.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

PROTOKOLLI I KONVENTËS SË VITIT 1979
PËR NDOTJEN NDËRKUFITARE TË AJRIT NË DISTANCË TË LARGËT PËR TË
PAKËSUAR ACIDIFIKIMIN, EUTROFIKIMIN DHE OZONIN NË SHTRESËN E POSHTME
TË ATMOSFERËS

Palët,

të vendosura për të zbatuar Konventën për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët;
të vetëdijshme se oksidet e azotit, squfuri, komponimet organike të paqëndrueshme dhe komponimet e azotit të reduktuar janë shoqëruar me ndikime negative për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;

të shqetësuara se ngarkesat kritike të acidifikimit, ngarkesat kritike të azotit nutrient dhe nivelet kritike të ozonit për shëndetin e njeriut dhe bimësinë ende tejkalohen në shumë zona të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për rajonin e Europës;

të shqetësuara gjithashtu se emetimet e oksideve të azotit, squfurit dhe komponimet organike të paqëndrueshme, si dhe ndotësit sekondarë si ozoni dhe produktet e reaksionit të amoniakut, transportohen në atmosferë në distanca të largëta dhe mund të kenë ndikime negative ndërkufitare;

duke pranuar se emetimet nga palët që bëjnë pjesë në Komisionin Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Rajonin e Europës, kontribuojnë në ndotjen e ajrit në shkallë hemisferike dhe globale, si dhe duke njohur mundësinë për transportim midis kontinenteve dhe nevojën për studime të mëtejshme në lidhje me këtë mundësi;



duke pranuar gjithashtu se Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë duke negociuar reciprokisht për uljen e emetimeve të oksideve të azotit dhe komponimeve organike të paqëndrueshme për të trajtuar ndikimin e ozonit ndërkufitar;

duke pranuar më tej se Kanadaja do të ndërmarrë reduktime të mëtejshme të emetimeve të squfurit në vitin 2010 përmes zbatimit të Strategjisë kanadeze - gjithëpërfshirëse për shiun acid pas vitit 2000, dhe se Shtetet e Bashkuara janë të angazhuara për zbatimin e një programi për reduktimin e oksideve të azotit në pjesën lindore të Shteteve të Bashkuara dhe për reduktimin e emetimeve, me qëllim që të përmbushë standardet kombëtare të cilësisë së ajrit të ambientit për lëndën e grimcuar;

të vendosura për të zbatuar një përjasje multiefektive, multindotëse për parandalimin ose minimizimin e tejkalimeve të ngarkesave dhe niveleve kritike;

duke marrë në konsideratë emetimet nga disa aktivitete dhe instalime ekzistuese, përgjegjëse për nivelet aktuale të ndotjes së ajrit dhe zhvillimin e aktiviteteve dhe instalimeve në të ardhmen;

të vetëdijshme se janë në dispozicion teknikat dhe praktikat menaxhuese për të reduktuar emetimet e këtyre substancave;

të vendosura që të marrin masa për të parashikuar, parandaluar ose minimizuar emetimet e këtyre substancave, duke marrë në konsideratë zbatimin e përjasjes parandaluese, siç përcaktohet në parimin 15 të Deklaratës së Rios për mjedisin dhe zhvillimin;

duke riafirmuar se shtetet, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare, kanë të drejtën sovrane të shfrytëzojnë burimet e tyre në pajtim me politikat e tyre mjedisore dhe të zhvillimit, si dhe përgjegjësinë për të siguruar që veprimtaritë brenda juridiksionit ose kontrollit të tyre nuk shkaktojnë dëmtimin e mjedisit të shteteve të tjera ose të zonave përtej kufijve të juridiksionit kombëtar;

të ndërgjegjshme për nevojën e një përjasjeje rajonale me kosto efektive për të luftuar ndotjen e ajrit që merr në konsideratë ndryshimet në efektet dhe uljen e kostove midis vendeve;

duke vërejtur kontributin e rëndësishëm të sektorit privat dhe joqeveritar për njohuritë në lidhje me ndikimet që shoqërojnë këto substanca dhe teknikat në dispozicion për zvogëlimin e tyre, si dhe rolin e këtyre sektorëve në ndihmën për uljen e emetimeve në atmosferë;

duke pasur parasysh se masat e marra për të reduktuar emetimet e oksideve të azotit, squfurit, amoniakut dhe komponimeve organike të paqëndrueshme nuk duhet të përbëjnë një mjet arbitrar ose të pajustificuar diskriminimi ose një kufizim të nënkuptuar në lidhje me konkurrencën ndërkombëtare dhe tregtinë;

duke marrë në konsideratë njohuritë më të mira të mundshme shkencore dhe teknike dhe të dhënat mbi emetimet, proceset atmosferike dhe ndikimet e këtyre substancave në shëndetin e njeriut dhe mjedis, si dhe në uljen e shpenzimeve, dhe duke pranuar nevojën për të përmirësuar këto njohuri dhe për të vazhduar bashkëpunimin shkencor dhe teknik për të kuptuar më tej këto çështje;

duke vërejtur se në kuadrin e Protokollit për kontrollin e emetimeve të oksideve të azotit ose flukseve të tyre ndërkufitare, të miratuar në Sofje më 31 tetor 1988, dhe Protokollit për kontrollin e emetimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme ose të flukseve të tyre ndërkufitare, të miratuar në Gjenevë më 18 nëntor 1991, ekziston tashmë dispozita për të kontrolluar emetimet e oksideve të azotit dhe komponimeve organike të paqëndrueshme, dhe se anekset teknike për të dy protokollat tashmë përmbajnë udhëzime teknike për reduktimin e këtyre emetimeve;

duke vërejtur gjithashtu se në bazë të protokollit për pakësimin e mëtejshëm të emetimeve të squfurit, të miratuar në Oslo më 14 qershor 1994, ekziston tashmë dispozita për të reduktuar emetimet e squfurit në mënyrë që të kontribuojë në zvogëlimin e depozitimeve acide, duke pakësuar tejkalimet e depozitimeve kritike të squfurit, të cilat e kanë prejardhjen nga sasitë kritike të aciditetit sipas kontributit të komponimeve të oksiduara të squfurit në depozitim total të aciditetit në vitin 1990;

duke vërejtur më tej se ky Protokoll është marrëveshja e parë sipas kësaj Konvente, që trajton në mënyrë specifike komponimet e azotit të reduktuar;

duke pasur parasysh se reduktimi i emetimeve të këtyre substancave mund të sigurojë përfitime të tjera shtesë për kontrollin e ndotësve të tjerë, duke përfshirë në veçanti aerosolet e grimcave ndërkufitare sekondare, të cilat kontribuojnë në ndikimet mbi shëndetin e njeriut që lidhen me ekspozimin ndaj grimcave të transportuara në rrugë ajrore;

duke pasur parasysh edhe nevojën që për arritjen e objektivave të këtij protokollit, të shmangët, për aq sa është e mundur, marrja e masave që përkeqësojnë probleme të tjera që lidhen me shëndetin dhe mjedisin;

duke vërejtur se masat e marra për uljen e emetimeve të oksideve të azotit dhe amoniakut duhet të marrin në konsideratë ciklin e plotë të azotit biogjeokimik dhe, aq sa është e mundur, të mos rrisin emetimet e azotit reaktiv, duke përfshirë oksidet e azotit të cilët mund të përkeqësojnë problemet e tjera që lidhen me azotin;

të vetëdijshme se metani dhe monoksidi i karbonit i emetuar nga aktivitetet njerëzore, në praninë e oksideve të azotit dhe komponimeve organike të paqëndrueshme, kontribuojnë në formimin e ozonit troposferik; dhe

të vetëdijshme edhe për angazhimet që palët kanë marrë përsipër në bazë të Konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimaterike, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Përkufizime

Për qëllime të këtij protokollit:

1. “Konventa” nënkupton Konventën për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët, e miratuar në Gjenevë më 13 nëntor 1979.
2. “EMEP” nënkupton Programin e bashkëpunimit për monitorimin dhe vlerësimin e transmetimit në distanca të largëta të ndotësve të ajrit në Europë.
3. “Organi ekzekutiv” nënkupton organin ekzekutiv për Konventën, i themeluar sipas nenit 10, paragrafi 1 i Konventës.
4. “Komisioni” nënkupton Komisionin Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën.
5. “Palët” nënkupton, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, palët e këtij protokollit.
6. “Shtirirja gjeografike e EMEP” nënkupton zonën e përcaktuar në nenin 1, paragrafi 4, të protokollit të Konventës së vitit 1979 për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët mbi financimin afatgjatë të programit të bashkëpunimit për monitorimin dhe vlerësimin e transmetimit në distancë të largët të ndotësve të ajrit në Europë (EMEP), miratuar në Gjenevë më 28 shtator 1984.
7. “Emetim” nënkupton shkarkimin e një substance nga një pikë ose burim shpërndarës në atmosferë.
8. “Oksidet e azotit” nënkupton oksidin e azotit dhe dyoksidin e azotit, të shprehura si dyoksidi i azotit (NO₂).
9. “Komponimet e azotit të reduktuar” nënkupton amoniakun dhe produktet e tij të reaksionit.
10. “Squfur” nënkupton të gjitha komponimet e squfurit të shprehura si dyoksidi i squfurit (SO₂).
11. “Komponime organike të paqëndrueshme” ose “VOC” nënkupton, përveç kur përcaktohet ndryshe, të gjitha komponimet organike me natyrë antropogjene, përveç metanit, që janë të afta të prodhojnë oksidantë fotokimikë nga reaksioni me oksidet e azotit në prani të dritës së diellit.
12. “Ngarkesa kritike” nënkupton një vlerësim sasior të një ekspozimi për një ose më shumë ndotës, nën të cilin nuk ndodhin ndikime të konsiderueshme të dëmshme mbi elemente të caktuara të ndjeshme të mjedisit, sipas njohurive të deritanishme.



13. “Nivelet kritike” nënkupton përqendrimet e ndotësve në atmosferë mbi vlerën e të cilëve mund të ndodhin ndikime të drejtpërdrejta negative tek receptorët, si për shembull qeniet njerëzore, bimët, ekosistemet apo materialet, sipas njohurive të deritanishme.

14. “Zona e menaxhimit të emetimeve të ndotësve” ose “PEMA” nënkupton një zonë të përcaktuar në aneksin III sipas kushteve të parashtruara në nenin 3, paragrafi 9.

15. “Burim i palëvizshëm” nënkupton çdo ndërtesë, strukturë, objekt, instalim apo pajisje fikse që emeton apo mund të emetojë në atmosferë squfur, okside të azotit, komponime organike të paqëndrueshme ose amoniak në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

16. “Burim i ri i palëvizshëm” nënkupton çdo burim të palëvizshëm, për të cilin ndërtimi ose modifikimi thelbësor ka filluar pas mbarimit të një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit. Kjo do të jetë një çështje për autoritetet kompetente kombëtare për të vendosur nëse një modifikim është thelbësor ose jo, duke i marrë në konsideratë këta faktorë si përfitime mjedisore të modifikimit.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij protokollit është të kontrollojë dhe të reduktojë emetimet e squfurit, oksideve të azotit, amoniakut dhe komponimeve organike të paqëndrueshme që shkaktohen nga aktivitete antropogjene për të cilat ekziston mundësia të kenë ndikime negative në shëndetin e njeriut, ekosistemet natyrore, materialet dhe të korrat, për shkak të acidifikimit, eutrofikimit ose ozonit në nivelin e poshtëm të atmosferës, si rezultat i transportit atmosferik ndërkufitar në distancë të largët, si dhe për të siguruar, aq sa është e mundur, që në plan afatgjatë dhe me një përjasje hap pas hapi, duke marrë në konsideratë përparimet në njohuritë shkencore, depozitimet atmosferike ose përqendrimet nuk tejkalojnë:

a) për palët brenda shtrirjes gjeografike të EMEP-së dhe Kanadasë, ngarkesat kritike të aciditetit, siç është përshkruar në aneksin I;

b) për palët brenda shtrirjes gjeografike të EMEP-së, ngarkesat kritike të azotit nutrient, si përshkruhet në aneksin I; dhe

c) për ozonin:

i) për palët brenda shtrirjes gjeografike të EMEP-së, nivelet kritike të ozonit, siç paraqitet në aneksin I;

ii) për Kanadanë, standardin gjithëpërfshirës të territorit të Kanadasë për ozonin; dhe

iii) për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, standardin kombëtar të cilësisë së ajrit të ambientit për ozonin.

Neni 3

Detyrimet themelore

1. Çdo palë që ka një tavan të emetimeve në cilëndo tabelë në aneksin II, do të zvogëlojë dhe do të mbajë reduktimin e emetimeve të saj vjetore në përputhje me atë tavan dhe afatet kohore të përcaktuara në atë aneks. Secila palë duhet, minimalisht, të kontrollojë emetimet e saj vjetore të komponimeve ndotëse, në përputhje me detyrimet në aneksin II.

2. Çdo palë duhet të zbatojë vlerat kufi të përcaktuara në anekset IV, V dhe VI për çdo burim të ri të palëvizshëm të klasifikuar në kategorinë e burimit të palëvizshëm sipas identifikimeve në këto anekse, jo më vonë se afatet kohore të përcaktuara në aneksin VII. Si alternativë, një palë mund të zbatojë strategji të ndryshme për zvogëlimin e emetimeve që arrijnë nivele të barasvlefshme emetimi të përgjithshëm për të gjitha kategoritë e burimeve së bashku.

3. Secila palë, për sa e lejojnë mundësitë teknike dhe ekonomike dhe duke marrë në konsideratë kostot dhe përparësitë, duhet të aplikojë vlerat kufi të përcaktuara në anekset IV, V dhe VI për çdo burim ekzistues të palëvizshëm të klasifikuar në kategorinë e burimit të palëvizshëm sipas identifikimeve në këto anekse, jo më vonë se afatet kohore të përcaktuara në shtojcën VII. Si alternativë, një palë mund të zbatojë strategji të ndryshme për zvogëlimin e emetimeve që arrijnë nivele të barasvlefshme emetimi të përgjithshëm për të gjitha kategoritë e burimeve së bashku, ose, për palët jashtë shtrirjes gjeografike të EMEP-së, që duhet të arrijnë synimet kombëtare apo rajonale për zvogëlimin e acidifikimit dhe të përmbushin standardet kombëtare të cilësisë së ajrit.

4. Vlerat kufi për kaldajat e reja dhe ekzistuese dhe ngrohësit me djegie me një kapacitet termik nominal që tejkalon 50 MWth dhe automjetet e reja të rënda do të vlerësohen nga palët në një sesion të organit ekzekutiv, me qëllim ndryshimin e anekseve IV, V dhe VIII jo më vonë se dy vjet pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokoll.

5. Çdo palë do të zbatojë vlerat kufi për lëndët djegëse dhe burimet e reja të lëvizshme të identifikuar në aneksin VIII, jo më vonë se afati kohor i përcaktuar në aneksin VII.

6. Çdo palë duhet të zbatojë teknikat më të mira në dispozicion për burimet e lëvizshme dhe për çdo burim të ri ose ekzistues të palëvizshëm, duke marrë në konsideratë dokumentet e udhëzuesit I deri V, të miratuar nga organi ekzekutiv në sesionin e tij të shtatëmbëdhjetë (vendimi 1999/1) dhe çdo ndryshim të tij.

7. Çdo palë, ndër të tjera, do të marrë masat e duhura, bazuar në kritere shkencore dhe ekonomike për reduktimin e emetimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme që lidhen me përdorimin e produkteve që nuk përfshihen në shtojcën VI ose VIII. Palët, jo më vonë se në sesionin e dytë të organit ekzekutiv pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll, duhet të shqyrtojnë me synim miratimin e një shtojce për produktet, duke përfshirë kriteret për përzgjedhjen e produkteve të tilla, vlerat kufi për përmbajtjen e komponimeve organike të paqëndrueshme të produkteve që nuk përfshihen në shtojcën VI ose VIII, si dhe afatet kohore për zbatimin e vlerave kufi.

8. Secila palë, në bazë të paragrafit 10:

a) do të aplikojë, minimalisht, masat për kontrollin e amoniakut të përcaktuara në aneksin IX; dhe

b) do të aplikojë, kur e konsideron të përshtatshme, teknikat më të mira në dispozicion për parandalimin dhe reduktimin e emetimeve të amoniakut, siç renditen në dokumentin udhëzues V, të miratuar nga organi ekzekutiv në sesionin e tij të shtatëmbëdhjetë (vendimi 1999/1) dhe çdo ndryshim të tij.

9. Paragrafi 10 do të zbatohet për çdo palë:

a) Sipërfaqja totale e tokës të së cilës është më e madhe se 2 milionë kilometra katrorë;

b) Emetimet vjetore të të cilave për sqfurin, oksidet e azotit, amoniakut dhe/ose komponimeve organike të paqëndrueshme kontribuojnë në acidifikimin, eutrofikimin ose formimin e ozonit në zonat nën juridiksionin e një ose më shumë palëve të tjera me origjinë kryesisht nga një zonë brenda juridiksionit të saj që është renditur si një PEMA në aneksin III, dhe e cila ka paraqitur dokumentacionin në përputhje me nënparagrafin (c) për këtë qëllim;

c) Që ka dorëzuar pas nënshkrimit, ratifikimit, pranimit ose miratimit, ose aderimit në këtë protokoll, një përshkrim të shtrirjes gjeografike të një ose më shumë PEMA-ve për një ose më shumë ndotës, me dokumentacionin mbështetës, për përfshirje në aneksin III; dhe

d) Që ka përcaktuar pas nënshkrimit, ratifikimit, pranimit ose miratimit, ose aderimit në këtë protokoll, qëllimin e saj për të vepruar në përputhje me këtë paragraf.

10. Një palë për të cilën zbatohet ky paragraf:

a) Nëse bën pjesë në shtrirjen gjeografike të EMEP-së, do t'i kërkohet që të jetë në përputhje me dispozitat e këtij neni dhe aneksin II vetëm për PEMA-n përkatëse për çdo ndotës për të cilën një PEMA nën juridiksionin e saj është përfshirë në aneksin III; ose



b) Nëse nuk bën pjesë në shtrirjen gjeografike të EME-së, do t'i kërkohej që të jetë në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1, 2, 3, 5, 6 dhe 7 dhe aneksit II, vetëm për PEMA-n përkatëse për çdo ndotës (oksidet e azotit, squfurit dhe/ose komponimet organike të paqëndrueshme) për të cilat një PEMA nën juridiksionin e saj është përfshirë në aneksin III, dhe nuk do t'i kërkohej të veprojë në përputhje me paragrafin 8 kudo nën juridiksionin e saj.

11. Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pas ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë protokoll, duhet t'i paraqesin organit ekzekutiv angazhimet e tyre përkatëse për reduktimin e emetimeve në lidhje me squfurin, oksidet e azotit dhe komponimet organike të paqëndrueshme për përfshirjen automatike në aneksin II.

12. Palët, në bazë të rezultatit të shqyrtimit të parë të parashikuar në nenin 10, paragrafi 2, dhe jo më vonë se një vit pas përfundimit të këtij shqyrtimi, fillojnë bisedimet për detyrimet e mëtejshme për të reduktuar emetimet.

Neni 4

Shkëmbimi i informacionit dhe teknologjia

1. Secila palë, në përputhje me ligjet, rregullat dhe praktikën e saj dhe në pajtim me detyrimet e saj sipas këtij protokoll, duhet të krijojë kushte të favorshme për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit, teknologjive dhe teknikave, me qëllim reduktimin e emetimeve të squfurit, oksideve të azotit, amoniakut dhe komponimeve organike të paqëndrueshme, duke nxitur ndër të tjera:

a) zhvillimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave për teknikat më të mira në dispozicion, duke përfshirë ato që rrisin efikasitetin e energjisë, djegësit me emetime të ulëta dhe praktikën e mirë mjedisore në bujqësi;

b) shkëmbimin e informacionit dhe përvojës në zhvillimin e sistemeve të transportit me më pak ndotës;

c) kontakte dhe bashkëpunime të drejtpërdrejta industriale, duke përfshirë ndërmarrjet e përbashkëta; dhe

d) ofrimin e asistencës teknike.

2. Në nxitje të aktiviteteve të përcaktuara në paragrafin 1, çdo palë duhet të krijojë kushte të favorshme për lehtësimin e kontakteve dhe bashkëpunimin ndërmjet organizatave dhe individëve përkatës në sektorët privatë dhe publikë që janë të aftë të sigurojnë teknologji, projekte dhe shërbime inxhinierike, pajisje apo financime.

Neni 5

Ndërgjegjësimi i publikut

1. Secila palë, në përputhje me ligjet, rregullat dhe praktikën e saj, duhet të nxisë dhënien e informacionit për publikun e gjerë, duke përfshirë informacione mbi:

a) emetimet vjetore kombëtare të squfurit, oksideve të azotit, amoniakut dhe komponimeve organike të paqëndrueshme dhe progresin drejt përputhshmërisë me tavanet e emetimeve kombëtare ose detyrimet e tjera të përmendura në nenin 3;

b) depozitimet dhe përqendrimet e ndotësve përkatës dhe, sipas rastit, këto depozitime dhe përqendrime në lidhje me ngarkesat dhe nivelet kritike të përmendura në nenin 2;

c) nivelet e ozonit troposferik; dhe

d) strategjitë dhe masat e zbatuara ose që do të zbatohen për zvogëlimin e problemeve të ndotjes së ajrit që trajtohen në këtë protokoll dhe të përcaktuara në nenin 6.

2. Për më tepër, çdo palë mund të vërë informacionin gjerësisht në dispozicion për publikun, me qëllim zvogëlimin e emetimeve, duke përfshirë informacione mbi:

a) lëndët djegëse më pak ndotëse, energjia e rinovueshme dhe efikasiteti i energjisë, duke përfshirë përdorimin e tyre në transport;

- b) komponimet organike të paqëndrueshme në produkte, duke përfshirë etiketimin;
- c) variantet e menaxhimit për mbetjet e krijuara nga publiku dhe që përmbajnë komponime organike të paqëndrueshme;
- d) praktikat e mira bujqësore për reduktimin e emetimeve të amoniakut;
- e) ndikimet mbi shëndetin dhe mjedisin që shoqërojnë ndotësit që mbulon ky protokoll; dhe
- f) hapat që individët dhe industrinë mund të marrin për të ndihmuar në reduktimin e emetimeve të ndotësve që mbulon ky protokoll.

Neni 6

Strategjitë, politikat, programet, masat dhe informimi

1. Secila palë, sipas nevojës dhe në bazë të kriterëve të qëndrueshme shkencore dhe ekonomike, me qëllim që të lehtësojë zbatimin e detyrimeve të saj sipas nenit 3:

a) do të miratojë pa vonesë strategjitë mbështetëse, politikat dhe programet pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll;

b) do të zbatojë masat për kontrollin dhe reduktimin e emetimeve të squfurit, oksideve të azotit, amoniakut dhe komponimeve organike të paqëndrueshme;

c) do të zbatojë masat për të nxitur rritjen e efikasitetit të energjisë dhe shfrytëzimin e energjive të rinovueshme;

d) do të zbatojë masat për uljen e përdorimit të lëndëve djegëse që shkaktojnë ndotje;

e) do të zhvillojë dhe prezantojë sistemet e transportit me më pak ndotje dhe të promovojë sistemet e menaxhimit të trafikut për të reduktuar emetimet e përgjithshme nga trafiku rrugor;

f) do të zbatojë masat për të inkurajuar zhvillimin dhe futjen e proceseve dhe produkteve që shkaktojnë ndotje të ulët, duke marrë në konsideratë dokumentet udhëzuese I deri V të miratuara nga organi ekzekutiv në sesionin e tij të shtatëmbëdhjetë (vendimi 1999/1) dhe të gjitha ndryshimet e tij;

g) do të nxisë zbatimin e programeve të menaxhimit për të reduktuar emetimet, duke përfshirë programet vullnetare dhe përdorimin e instrumenteve ekonomike, duke marrë parasysh dokumentin udhëzues VI të miratuar nga organi ekzekutiv në sesionin e tij të shtatëmbëdhjetë (vendimin 1999/1) dhe të gjitha ndryshimet e tij;

h) do të zbatojë dhe përpunojë më tej politikat dhe masat në përputhje me rrethanat e saj kombëtare, si reduktimi progresiv ose zvogëlimi ose ulja graduale e defekteve të tregut, stimujt fiskalë, përjashtimet nga taksat dhe detyrimet doganore dhe subvencionet në të gjithë sektorët që emetojnë squfur, okside të azotit, amoniak dhe komponime organike të paqëndrueshme të cilat bien ndesh me objektivin e protokollit dhe zbatimin e instrumenteve të tregut; dhe

i) do të zbatojë masat, kur janë me kosto efektive, për reduktimin e emetimeve nga produktet e mbetjeve që përmbajnë komponime organike të paqëndrueshme.

2. Secila palë duhet të mbledhë dhe ruajë informacione mbi:

a) nivelet aktuale të emetimeve të squfurit, komponimeve të azotit dhe komponimeve organike të paqëndrueshme, dhe përqendrimit dhe depozitimit në mjedis të këtyre komponimeve dhe ozonit, duke marrë parasysh, për ato palë që bëjnë pjesë në shtrirjen gjeografike të EMEP-së, planin e punës së EMEP-së; dhe

b) ndikimet e përqendrimeve në mjedis dhe të depozitimeve të squfurit, komponimeve të azotit, komponimeve organike të paqëndrueshme dhe ozonit në shëndetin e njeriut, ekosistemet tokësore dhe ujore dhe materiale.

3. Çdo palë mund të marrë masa më të rrepta sesa ato që kërkohen nga ky protokoll.



Neni 7 Raportimi

1. Në bazë të ligjeve dhe rregullave të saj dhe në përputhje me detyrimet sipas këtij protokollit:

a) Secila palë, nëpërmjet Sekretarit Ekzekutiv të Komisionit, do të raportojë tek organi ekzekutiv informacionin mbi masat që ajo ka marrë për zbatimin e këtij protokollit, në mënyrë periodike, të përcaktuar nga palët në një sesion të organit ekzekutiv. Për më tepër:

i) kur një palë, për reduktimin e emetimeve zbaton strategji të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 3, paragrafët 2 dhe 3, ajo duhet të dokumentojë strategjitë e zbatuara dhe pajtueshmërinë e saj me kërkesat e këtyre paragrafëve;

ii) kur një palë gjykon se vlerat e caktuara kufi, siç është përcaktuar në përputhje me nenin 3, paragrafi 3, duke pasur parasysh kostot dhe përparësitë, nuk janë teknikisht dhe ekonomikisht të mundshme, ai do të raportojë dhe do ta justifikojë këtë;

b) Secila palë që bën pjesë në shtrirjen gjeografike të EMEP-së, përmes Sekretarit Ekzekutiv të Komisionit, në mënyrë periodike të përcaktuar nga organi drejtues i EMEP-së dhe të miratuar nga palët në një sesion të organit ekzekutiv, do të raportojë tek EMEP-ja informacionin e mëposhtëm:

i) Nivelet e emetimeve të squfurit, oksideve të azotit, amoniakut dhe komponimeve organike të paqëndrueshme duke përdorur, minimalisht, metodologjitë dhe zgjidhjet e përkohshme dhe të pjesshme të përcaktuara nga organi drejtues i EMEP-së;

ii) Nivelet e emetimeve të çdo substance në vitin referues (1990), duke përdorur të njëjtat metodologji dhe zgjidhje të përkohshme dhe të pjesshme;

iii) Të dhëna për emetimet e projektuara dhe planet aktuale të uljeve; dhe

iv) Në rastet kur e çmon të përshtatshme, çdo rrethanë të jashtëzakonshme që justifikon emetimet që janë përkohësisht më të larta se tavanet e përcaktuara për të për një apo më shumë ndotës; dhe

c) Palët në zonat jashtë shtrirjes gjeografike të EMEP-së duhet të vënë në dispozicion informacion të ngjashëm me atë të përcaktuar në nënparagrafin (b), nëse i kërkohet nga organi ekzekutiv ta bëjë këtë.

2. Informacioni që do të raportohet në përputhje me paragrafin 1 (a) do të jetë në përputhje me një vendim në lidhje me formatin dhe përmbajtjen që do të miratohet nga palët në një sesion të organit ekzekutiv.

Kushtet e këtij vendimi duhet të shqyrtohen si të nevojshme për të identifikuar elementet shtesë në lidhje me formën ose përmbajtjen e informacionit që do të përfshihet në raporte.

3. Në kohë të përshtatshme, përpara çdo sesioni vjetor të organit ekzekutiv, EMEP-ja do të ofrojë informacion për:

a) përqendrimet dhe depozitimet në mjedis të squfurit dhe komponimeve të azotit, si dhe kur janë në dispozicion, përqendrimet e komponimeve organike të paqëndrueshme dhe të ozonit në mjedis; dhe

b) llogaritjet e buxheteve të squfurit dhe oksideve të azotit dhe azotit të reduktuar dhe informacionin e nevojshëm për transportin në distancë të largët të ozonit dhe prekursorëve të tij.

Palët në zonat jashtë shtrirjes gjeografike të EMEP-së do të vënë në dispozicion informacione të ngjashme, nëse kjo kërkohet nga organi ekzekutiv.

4. Organi ekzekutiv, në pajtim me nenin 10, paragrafi 2 (b) të Konventës, do të marrë masa për përgatitjen e informacionit mbi efektet e depozitimeve të squfurit dhe komponimeve të azotit dhe përqendrimeve të ozonit.

5. Palët, në sesionet e organit ekzekutiv, në intervale të rregullta, do të marrin masa për përgatitjen e informacionit të rishikuar në lidhje me alokimet e llogaritura dhe të optimizuara në nivel ndërkombëtar për zvogëlimin e emetimeve për shtetet që hyjnë brenda shtrirjes gjeografike të EMEP-së, duke përdorur modelet e integruara të vlerësimit, duke përfshirë modele të transportit atmosferik, me qëllim reduktimin e mëtejshëm, sipas nenit 3, paragrafi 1, diferencën midis depozitimeve aktuale të sqfurit dhe komponimeve të azotit dhe vlerave të ngarkesës kritike, si dhe diferencën midis përqendrimeve aktuale të ozonit dhe niveleve kritike të ozonit të përcaktuara në aneksin I, apo metoda alternative vlerësimi të miratuara nga palët në një sesion të organit ekzekutiv.

Neni 8

Kërkimi, zhvillimi dhe monitorimi

Palët duhet të inkurajojnë kërkimin, zhvillimin, monitorimin dhe bashkëpunimin në lidhje me:

a) harmonizimin ndërkombëtar të metodave për llogaritjen dhe vlerësimin e ndikimeve negative në lidhje me substancat e trajtuara nga ky protokoll për t'i përdorur në vendosjen e ngarkesave kritike dhe niveleve kritike dhe, sipas nevojës, përpunimin e procedurave për këtë harmonizim;

b) përmirësimin e bazave të të dhënave të emetimeve, në veçanti ato të amoniakut dhe komponimeve organike të paqëndrueshme;

c) përmirësimin e teknikave dhe sistemeve të monitorimit dhe të modelimit të transportit, përqendrimeve dhe depozitimeve të sqfurit, komponimeve të azotit dhe komponimeve organike të paqëndrueshme, si dhe formimit të ozonit dhe grimcave sekondare;

d) përmirësimin e të kuptuarit shkencor të së ardhmes afatgjatë të emetimeve dhe ndikimit të përqendrimit të tyre në sfondin hemisferik për sqfurin, azotin, komponimet organike të paqëndrueshme, ozonin dhe lëndën e grimcuar, duke u përqendruar, në veçanti, në kiminë e troposferës së lirë dhe mundësinë e shpërndarjes ndërkontinentale të ndotësve;

e) përpunimin e mëtejshëm të një strategjie të përgjithshme për uljen e ndikimeve negative të acidifikimit, eutrofikimit dhe ndotjes fotokimike, duke përfshirë bashkëveprimin dhe efektet e kombinuara;

f) strategjitë për reduktimin e mëtejshëm të emetimeve të sqfurit, oksideve të azotit, amoniakut dhe komponimeve organike të paqëndrueshme, bazuar në ngarkesat dhe nivelet kritike, si dhe në zhvillimet teknike, dhe përmirësimin e modeleve të integruara të vlerësimit për llogaritjen e alokimeve të optimizuara në nivel ndërkombëtar për zvogëlimin e emetimit, duke marrë parasysh nevojën për të shmangur shpenzimet e tepërta për çdo palë. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet emetimeve nga bujqësia dhe transporti;

g) identifikimin e tendencave në kohë dhe kuptimit shkencor të efekteve në shkallë më të gjerë të sqfurit, azotit dhe komponimeve organike të paqëndrueshme dhe ndotjes fotokimike për shëndetin e njeriut, duke përfshirë edhe kontributin e tyre në përqendrimit e lëndëve të grimcuara, në mjedis, në veçanti acidifikimin dhe eutrofikimin, dhe materialet, në veçanti monumentet historike dhe kulturore, duke marrë parasysh marrëdhënien midis oksideve të sqfurit, oksideve të azotit, amoniakut, komponimeve organike të paqëndrueshme dhe ozonit troposferik;

h) teknologjitë e zvogëlimit të emetimeve, teknikat dhe teknologjitë për të përmirësuar efikasitetin e energjisë, ruajtjen e energjisë dhe shfrytëzimin e energjisë së rinovueshme;

i) efikasitetin e teknikave të kontrollit të amoniakut për fermat dhe ndikimin e tyre në depozitimin lokal dhe rajonal;

j) menaxhimin e kërkesës për transport dhe zhvillimin dhe promovimin e mënyrave të transportit me më pak ndotës;



k) përcaktimin e sasisë dhe, kur është e mundur, vlerësimin ekonomik të përfitimeve për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si rezultat i reduktimit të emetimeve të squfurit, të oksideve të azotit, amoniakut dhe komponimeve organike të paqëndrueshme; dhe

l) zhvillimin e mjeteve për të bërë që metodat dhe rezultatet e kësaj pune të jenë gjerësisht të zbatueshme dhe të vlefshme.

Neni 9

Pajtueshmëria

Pajtueshmëria e secilës palë me detyrimet e saj sipas këtij protokoll do të shqyrtohet rregullisht. Komisioni i zbatimit i themeluar me vendimin 1997/2 të organit ekzekutiv në seancën e tij të pesëmbëdhjetë do të kryejë shqyrtimet dhe do të raportojë për palët në një sesion të organit ekzekutiv, në përputhje me kushtet e shtojcës të këtij vendimi, duke përfshirë çdo ndryshim në të.

Neni 10

Rishqyrtimet nga palët në seancat e organit ekzekutiv

1. Palët, në seancat e organit ekzekutiv, në bazë të nenit 10, paragrafi 2 (a), të Konventës, do të rishikojnë informacionet e dhëna nga palët, EMEP-ja dhe organet ndihmëse të organit ekzekutiv, të dhënat mbi ndikimet e përqendrimeve dhe depozitimeve të squfurit dhe komponimeve të azotit dhe të ndotjes fotokimike, si dhe raportet e Komisionit të zbatimit të përmendura në nenin 9 më sipër.

2. a) Palët, në seancat e organit ekzekutiv, do të mbajnë nën rishqyrtim detyrimet e përcaktuara në këtë protokoll, duke përfshirë:

i) detyrimet e tyre në lidhje me alokimet e llogaritura dhe të optimizuara në nivel ndërkombëtar për zvogëlimet e emetimeve të përmendura në nenin 7, paragrafi 5, më sipër; dhe

ii) përshtatshmërinë e detyrimeve dhe përparimin e bërë drejt arritjes së qëllimit të këtij protokoll.

b) Rishikimet do të marrin në konsideratë informacionet shkencore më të mira në dispozicion për ndikimet e acidifikimit, eutrofikimit dhe ndotjes fotokimike, duke përfshirë vlerësimet e të gjitha ndikimeve përkatëse në shëndet, nivelet dhe ngarkesat kritike, zhvillimin dhe përpunimin e modeleve të integruara të vlerësimit, zhvillimet teknologjike, kushtet e ndryshimit ekonomik, përparimin e bërë në bazat e të dhënave për emetimet dhe teknikat e zvogëlimit, veçanërisht në lidhje me amoniakun dhe komponimet organike të paqëndrueshme, dhe përmbushjen e detyrimeve për nivelet e emetimeve.

c) Procedurat, metodat dhe koha për këto komente do të përcaktohen nga palët në një sesion të organit ekzekutiv. Shqyrtimi i parë për këtë do të fillojë jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rast të një mosmarrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij protokoll, palët e interesuara do të kërkojnë një zgjidhje të mosmarrëveshjes nëpërmjet negocimit ose mjeteve të tjera paqësore të zgjedhura prej tyre. Palët e mosmarrëveshjes duhet të njoftojnë organin ekzekutiv për mosmarrëveshjen e tyre.

2. Pas ratifikimit, pranimit, miratimit, ose aderimit në këtë protokoll, ose në çdo kohë më pas, një palë, e cila nuk është organizatë rajonale e integritit ekonomik, mund të deklarojë me

shkrim tek depozitari që, për sa i përket ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me ndonjë interpretim ose zbatim të protokollit, ajo njeh një ose të dyja mjetet e mëposhtme të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si të detyrueshme *ipso facto* dhe pa marrëveshje të veçantë, në lidhje me çdo palë që pranon detyrime të njëjta:

a) Paraqitja e mosmarrëveshjes në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë;

b) Arbitrazhi, në përputhje me procedurat që do të miratohen sa më shpejt të jetë e mundur nga palët në një sesion të organit ekzekutiv në një shtojcë për arbitrazhin.

Një palë e cila është organizatë rajonale ekonomike e integruar mund të bëjë një deklaratë me efekt të ngjashëm në lidhje me arbitrazhin, në përputhje me procedurat e përmendura në nënparagrafin (b).

3. Një deklaratë e bërë sipas paragrafit 2 do të mbetet në fuqi brenda afatit të saj ose deri në tre muaj pasi njoftimi me shkrim për revokimin e saj të jetë depozituar tek depozitari.

4. Një deklaratë e re, një njoftim për anulimin apo skadimin e një deklarate nuk duhet në asnjë mënyrë të ndikojë në procedurat në pritje për t'u shqyrtuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë ose gjykatën e arbitrazhit, përveç kur palët e mosmarrëveshjes bien dakord ndryshe.

5. Me përjashtim të rastit kur palët e një mosmarrëveshjeje kanë pranuar të njëjtat mjete të zgjidhjes së mosmarrëveshjes sipas paragrafit 2, nëse pas dymbëdhjetë muajve nga njoftimi i një pale tek pala tjetër se ekziston një mosmarrëveshje ndërmjet tyre, palët e interesuara nuk kanë qenë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre nëpërmjet mjeteve të përmendura në paragrafin 1, mosmarrëveshja do të paraqitet për pajtim, me kërkesë të cilësdo palë të mosmarrëveshjes.

6. Për qëllim të paragrafit 5, do të krijohet një komision pajtimi. Komisioni do të përbëhet nga një numër i barabartë i anëtarëve të emëruar nga secila palë e interesuar ose, kur palët në pajtim ndajnë të njëjtin interes, me grupin që ndan atë interes, si dhe një kryetar të zgjedhur bashkërisht nga anëtarët e emëruar. Komisioni merr një vendim rekomandues, që palët në mosmarrëveshje e shqyrtojnë në mirëbesim.

Neni 12

Anekset

Anekset e këtij protokollit do të jenë pjesë përbërëse të protokollit.

Neni 13

Ndryshimet dhe rregullimet

1. Çdo palë mund të propozojë ndryshime në këtë protokoll. Çdo palë në Konventë mund të propozojë një rregullim të shtojcës II të këtij protokollit për të shtuar në të emrin e vet, së bashku me nivelet e emetimeve, tavanet e emetimeve dhe zvogëlimin e emetimeve në përqindje.

2. Ndryshimet dhe rregullimet e propozuara do të paraqiten me shkrim tek Sekretari Ekzekutiv i Komisionit, i cili do t'i komunikojnë ato për të gjitha palët. Palët do të diskutojnë ndryshimet dhe rregullimet e propozuara në seancën e ardhshme të organit ekzekutiv, me kusht që këto propozime të jenë kaluar tek palët nga Sekretari Ekzekutiv të paktën nëntëdhjetë ditë përpara.

3. Ndryshimet në këtë protokoll, duke përfshirë ndryshimet në anekset II deri IX, do të miratohen me konsensus nga palët e pranishme në një sesion të organit ekzekutiv dhe do të hyjnë në fuqi për palët që i kanë pranuar ato në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën dy të tretat e palëve kanë depozituar tek depozitari instrumentet e tyre të pranimit për këtë. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi për çdo palë tjetër ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën kjo palë ka depozituar instrumentin e saj të pranimit për këtë.

4. Ndryshimet e shtojcave të këtij protokollit, përveç anekseve të përmendura në paragrafin 3, do të miratohen me konsensus të palëve të pranishme në një seancë të organit ekzekutiv. Pas



kalimit të nëntëdhjetë ditëve nga data e komunikimit të tij nga Sekretari Ekzekutiv i Komisionit për të gjitha palët, amendimi i këtij aneksi do të hyjë në fuqi për ato palë që nuk kanë paraqitur tek depozitari një njoftim në përputhje me dispozitat e paragrafit 5, me kusht që të paktën gjashtëmbëdhjetë palë të mos kenë paraqitur një njoftim të tillë.

5. Çdo palë që nuk është në gjendje të miratojë një ndryshim në një aneks, përveç të një aneksi të përmendur në paragrafin 3, do të njoftojë depozitarin me shkrim brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e komunikimit të miratimit të saj. Depozitari do të njoftojë pa vonesë të gjitha palët për çdo njoftim të tillë të marrë. Një palë, në çdo kohë, mund të zëvendësojë një pranim për njoftimin e saj të mëparshëm dhe, pas depozitimit të një instrumenti pranimit tek depozitari, amendamenti për një shtojcë të tillë do të hyjë në fuqi për atë palë.

6. Rregullimet në aneksin II duhet të miratohen me konsensus të palëve të pranishme në një sesion të organit ekzekutiv, dhe hyjnë në fuqi për të gjitha palët e këtij protokollit, ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën Sekretari Ekzekutiv i Komisionit njofton ato palë me shkrim për miratimin e rregullimit.

Neni 14

Nënshkrimi

1. Ky protokoll do të paraqitet për nënshkrim në Gotenburg (Suedi), më 30 nëntor dhe 1 dhjetor 1999, më pas në zyrat qendrore të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork deri më 30 maj 2000, nga shtetet anëtare të Komisionit, si dhe shtetet që kanë status konsultativ në Komision, sipas paragrafit 8 të rezolutës të Këshillit Ekonomik dhe Social 36 (IV) të 28 marsit 1947, dhe nga organizatat rajonale të integritit ekonomik, që përbëhet nga shtete anëtare të pavarura të Komisionit, të cilët kanë kompetenca në lidhje me negocimin, lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në çështjet që mbulohen nga protokollit, me kusht që shtetet dhe organizatat e interesuara të jenë palë në Konventë dhe të renditen në aneksin II.

2. Në çështjet brenda kompetencave të tyre, organizatat rajonale të integritit ekonomik, në emër të tyre, do të ushtrojnë të drejtat dhe përbushin përgjegjësitë që ky protokoll i atribuon shteteve të tyre anëtare. Në raste të tilla, shtetet anëtare të këtyre organizatave nuk kanë të drejtë t'i ushtrojnë individualisht këto të drejta.

Neni 15

Ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Ky protokoll do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga nënshkruesit.
2. Ky protokoll do të paraqitet për pranim më 31 maj 2000 nga ana e shteteve dhe organizatave që plotësojnë kushtet e nenit 14, paragrafi 1.
3. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit do të depozitohen pranë depozitarit.

Neni 16

Depozitari

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë depozitari.

Neni 17

Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll hyn në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit tek depozitari.

2. Për çdo shtet dhe organizatë që përmbush kërkesat e nenit 14, paragrafi 1, i cili ratifikon, pranon ose miraton këtë protokoll ose aderon pas depozitimit të instrumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, protokollin do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit nga pala të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 18 Tërheqja

Në çdo kohë pas pesë viteve nga data në të cilën ky protokoll ka hyrë në fuqi për një palë, kjo palë mund të tërhiqet nga protokollin, duke dhënë njoftimin me shkrim tek depozitari. Kjo tërheqje do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së pranimit të tij nga depozitari, ose në një datë të mëvonshme që mund të përcaktohet në njoftimin e tërheqjes.

Neni 19 Tekstet autentike

Originali i këtij protokollin, për të cilin tekstet në gjuhën angleze, frënge dhe ruse janë njëlloj autentike, do të depozitohet pranë sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar sipas rregullit për këtë, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Gotenburg (Suedi), më tridhjetë nëntor njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë.

ANEKSI I NGARKESAT DHE NIVELET KRITIKE

I. NGARKESAT KRITIKE TË ACIDITETIT

A. Për palët që hyjnë në shtrirjen gjeografike të EMEP-së

1. Ngarkesat kritike (siç përkufizohet në nenin 1) të aciditetit për ekosistemet janë përcaktuar në përputhje me manualin e konventës për metodat dhe kriteret për ndarjen e niveleve/ngarkesave kritike dhe zonave gjeografike ku ato janë tejkualuar. Ato janë shuma maksimale e depozitimit acidifikues që një ekosistem mund të tolerojë pa u dëmtuar në periudhë afatgjatë. Ngarkesat kritike të aciditetit në lidhje me azotin marrin në konsideratë proceset e largimit të azotit (p.sh. marrjen nga bimët) brenda ekosistemit. Ngarkesat kritike të aciditetit në lidhje me squfurin nuk e marrin në konsideratë. Një ngarkesë kritike e kombinuar e aciditetit të squfurit dhe azotit e merr në konsideratë azotin vetëm kur depozitimi i azotit është më i madh sesa në proceset e largimit të azotit nga ekosistemi. Të gjitha ngarkesat kritike të raportuara nga palët përmbledhen për përdorim në modelimet e vlerësimit të integruar të shfrytëzuar për të dhënë udhëzimet në shtojcën II për përcaktimin e tavaneve të emetimeve.

B. Për palët në Amerikën e Veriut

2. Për Kanadanë Lindore, ngarkesat kritike të squfurit dhe azotit për ekosistemet pyjore janë përcaktuar me metoda dhe kriteret shkencore (Vlerësimi Kanadez i Shiut Acid, 1997) të ngjashme me ato të manualit të konventës për metodat dhe kriteret për ndarjen e niveleve kritike/ngarkesave dhe zonave gjeografike ku ato janë tejkualuar. Vlerat e ngarkesave kritike të aciditetit të Kanadasë Lindore (siç përkufizohet në nenin 1) janë për sulfatet në reshjet të shprehura në kg/orë/vit. Alberta në Kanadanë perëndimore, ku nivelet e depozitimit janë aktualisht nën kufijtë mjedisorë, për aciditetin potencial ka miratuar sistemet e klasifikimit të përgjithshëm të ngarkesave kritike që përdoret për tokën në Europë. Aciditeti potencial përcaktohet me anë të veçimit nga depozitimi total (i lagësht dhe i thatë së bashku) të kationeve bazë nga ai i squfurit dhe azotit. Përveç ngarkesave kritike për aciditetin potencial, Alberta ka përcaktuar objektivin dhe monitorimin e ngarkesave për menaxhimin e emetimeve acidifikuese.



3. Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndikimet e acidifikimit vlerësohen nëpërmjet vlerësimit të ndjeshmërisë së ekosistemeve, ngarkimit të përgjithshëm brenda ekosistemeve me komponime acidifikuese dhe pasigurisë që shoqëron proceset e largimit të azotit brenda ekosistemeve.

4. Këto ngarkesa dhe ndikime janë përdorur në modelimin e vlerësimit të integruar dhe ofrojnë udhëzime për përcaktimin e taveve të emetimeve dhe/ose reduktime për Kanadanë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në aneksin II.

II. NGARKESAT KRITIKE TË AZOTIT NUTRIENT

Për palët që hyjnë brenda shtrirjes gjeografike të EMEP-së

5. Sasitë kritike (siç përkufizohet në nenin 1) të azotit nutrient (eutrofikimi) për ekosistemet janë përcaktuar në përputhje me manualin e konventës për metodat dhe kriteret për ndarjen e niveleve kritike/ngarkesave dhe zonave gjeografike ku ato janë tejkualuar. Ato janë shuma maksimale e depozitimeve të azotit eutrofik që një ekosistem mund të tolerojë pa u dëmtuar në periudhë afatgjatë. Të gjitha ngarkesat kritike të raportuara nga palët përmblihen për përdorim në modelin e vlerësimit të integruar për të siguruar udhëzimet në aneksin II për përcaktimin e taveve të emetimeve.

III. NIVELET KRITIKE TË OZONIT

A. Për palët që hyjnë brenda shtrirjes gjeografike të EMEP-së

6. Nivelet kritike (siç përkufizohet në nenin 1) të ozonit për mbrojtjen e bimëve janë vendosur në pajtim me manualin e konventës për metodat dhe kriteret për ndarjen e niveleve kritike/ngarkesave dhe zonave gjeografike ku ato janë tejkualuar. Ato janë shprehur si ekspozim kumulativ mbi përqendrimin e pragut të ozonit prej 40 ppb (pjesë për bilion në vëllim). Ky indeks ekspozimi është referuar këtu si AOT40 (ekspozim i akumuluar mbi një prag prej 40 ppb). AOT40 është llogaritur si shuma e diferencave ndërmjet përqendrimit në një orë (në ppb) dhe 40 ppb për çdo orë, kur përqendrimi tejkalon 40 ppb.

7. Niveli afatgjatë kritik i ozonit për prodhimet e një AOT40 e 3000 ppb.orë në periudhën maj-korrik (i përdorur si sezon tipik për kultivimin) dhe për orët e ditës është përdorur për të përcaktuar zonat në rrezik ku niveli kritik është tejkualuar. Në modelimet e vlerësimit të integruar të ndërmarra për ozonin, ulja specifike e tejkalimeve ishte objektivi në këtë protokoll për të siguruar udhëzimet për përcaktimin e taveve të emetimeve në aneksin II. Niveli afatgjatë kritik i ozonit për prodhimet merret në konsideratë gjithashtu për mbrojtjen e bimëve të tjera si për shembull pemët dhe bimësia natyrore. Për të zhvilluar një interpretimin më të diferencuar për tejkalimet e niveleve kritike të ozonit për bimësinë, po kryhen punime shkencore të mëtejshme.

8. Në udhëzuesin e cilësisë së ajrit, të OBSH-së është paraqitur niveli kritik i ozonit për shëndetin e njeriut me vlerë $120 \mu\text{g}/\text{m}^3$ si mesatare 8-orëshe. Në bashkëpunim me Zyrën Rajonale për Europën të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH/EURO), një nivel kritik i shprehur si një AOT60 (ekspozim i akumuluar mbi pragun prej 60 ppb), d.m.th. $120 \mu\text{g}/\text{m}^3$, i llogaritur për një vit, është miratuar si zëvendësues për udhëzuesin e cilësisë së ajrit, të OBSH-së për modelimin e vlerësimit të integruar. Ky u përdor për të përcaktuar zonat në rrezik ku është tejkualuar niveli kritik. Në modelimet e vlerësimit të integruar të ndërmarra për ozonin ulja specifike e tejkalimeve ishte objektivi në këtë protokoll për të siguruar udhëzimet për përcaktimin e taveve të emetimeve në aneksin II.

B. Për palët në Amerikën e Veriut

9. Për Kanadanë, janë vendosur nivelet kritike të ozonit për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit dhe janë përdorur për të krijuar një standard gjithëpërfshirës kanadez për ozonin. Tavanet e emetimeve në aneksin II janë vendosur në përputhje me nivelin ambicioz që kërkohet të arrihet me standardin gjithëpërfshirës kanadez për ozonin.

10. Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë vendosur nivelet kritike të ozonit për mbrojtjen e shëndetit të publikut me një kufi të përshtatshëm të sigurisë, për të mbrojtur mirëqenien publike nga ndonjë ndikim negativ i njohur apo i pritshëm, dhe janë përdorur për të vendosur standardin kombëtar të cilësisë së ajrit të ambientit. Për të siguruar udhëzime për përcaktimin e taveve të emetimeve dhe/ose zvogëlimeve për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në aneksin II janë përdorur modelimet e vlerësimit të integruar dhe standardet e cilësisë së ajrit.

ANEKSI II
TAVANET E EMETIMEVE
(Amenduar në dhjetor 2005)

Tavanet e emetimeve të renditura në tabelat më poshtë lidhen me dispozitat e nenit 3, paragrafët 1 dhe 10, të këtij protokollit. Nivelet e emetimeve të vitit 1980 dhe 1990 dhe reduktimet e emetimeve në përqindje të renditura janë dhënë vetëm për qëllime informimi.

TABELA 1
TAVANET E EMETIMEVE PËR SQUFURIN (MIJË TON SO₂ NË VIT)

Pala	Nivelet e emetimeve		Tavanet e emetimeve për vitin 2010	Zvogëlimi i emetimeve në përqindje për vitin 2010 (viti bazë 1990)
	1980	1990		
Armenia	141	73	73	0%
Austria	400	91	39	-57%
Bjellorusia	740	637	480	-25%
Belgjika	828	372	106	-72%
Bullgaria	2050	2008	856	-57%
Kanadaja ^{a)}	4643	3236		
PEMA (SOMA)	3135	1873		
Kroacia	150	180	70	-61%
Qipro ^{d)}	28	46	39	-15%
Republika Çeke	2257	1876	283	-85%
Danimarka	450	182	55	-70%
Finlanda	584	260	116	-55%
Franca	3208	1269	400	-68%
Gjermania	7514	5313	550	-90%
Greqia	400	509	546	7%
Hungaria	1633	1010	550	-46%
Irlanda	222	178	42	-76%
Italia	3757	1651	500	-70%
Letonia	-	119	107	-10%
Lihtenshtajni	0.39	0.15	0.11	-27%
Lituania	311	222	145	-35%
Luksemburgu	24	15	4	-73%
Holanda	490	202	50	-75%
Norvegjia	137	53	22	-58%
Polonia	4100	3210	1397	-56%
Portugalia	266	362	170	-53%
Republika e Moldovës	308	265	135	-49%



Rumania	1055	1311	918	-30%
Federata Ruse ^{b)}	7161	4460		
PEMA	1062	1133	635	-44%
Slovakia	780	543	110	-80%
Slovenia	235	194	27	-86%
Spanja ^{b)}	2959	2182	774	-65%
Suedia	491	119	67	-44%
Zvicra	116	43	26	-40%
Ukraina	3849	2782	1457	-48%
Mbretëria e Bashkuar	4863	3731	625	-83%
Shtetet e Bashkuara të Amerikës ^{c)}				
Komuniteti European	26456	16436	4059	-75%

^{a)} Pas ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë protokoll, Kanadaja do të paraqesë një tavan të emetimit për sqfurin, ose në një nivel kombëtar ose për PEMA-n e saj, dhe do të përpiqet të sigurojë një tavan për 2010. PEMA e sqfurit do të jetë fusha e menaxhimit të oksideve të sqfurit (SOMA) që është caktuar në pajtim me aneksin III të protokollit për pakësimin e mëtejshëm të emetimeve të sqfurit, të miratuar në Oslo më 14 qershor 1994 si SOMA e Kanadasë Juglindore. Kjo është një sipërfaqe prej 1 milion km², e cila përfshin të gjithë territorin e krahinave: Prince Edward Island, Nova Scotia dhe New Brunswick, të gjithë territorin e provincës së Kebekut jugor, në një vijë të drejtë midis Havre-St. Pierre në bregdetin verior të Gjirit të Shën Lorencit dhe pika ku kufiri Quebec-Ontario kryqëzon bregdetin e Gjirit të James, dhe të gjithë territorin e provincës së Ontarios jugore në një vijë të drejtë midis pikës ku kufiri Ontario-Quebec kryqëzon bregdetin e gjirit të James dhe Lumin Nipigon pranë bregut verior të Liqenit të Sipërm.

^{b)} Shifrat aplikohen për pjesën Europiane brenda zonës EMEP.

^{c)} Pas ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit të këtij protokollit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të sigurojnë përfshirjen në këtë shtojcë të: a) masave për reduktimin e emetimeve specifike të sqfurit, të zbatueshme për burimet e lëvizshme dhe të palëvizshme që do të zbatohen ose në nivel kombëtar, ose brenda një PEMA, nëse është paraqitur një PEMA e sqfurit për t'u përfshirë në aneksin III; b) vlerës të përgjithshme të sqfurit të vlerësuar në nivelet e emetimit për vitin 1990, ose kombëtare ose për PEMA-n; c) vlerën treguese për nivelet e përgjithshme të sqfurit për vitin 2010, ose kombëtare ose për PEMA-n; dhe d) vlerësimet në lidhje me përqindjen e reduktimit të emetimeve të sqfurit. Pika (b) do të përfshihet në tabelë dhe pikat (a), (c) dhe (d) do të përfshihen në një shënim në tabelë.

^{d)} Shifrat për Qipron, miratuar në sesionin e 23-të të organit ekzekutiv.

TABELA 2
TAVANET E EMETIMEVE PËR OKSIDET E AZOTIT (MIJË TON NO₂ NË VIT)

Pala	Nivelet e emetimeve 1990	Tavanet e emetimeve për vitin 2010	Zvogëlimi i emetimeve në përqindje për vitin 2010 (viti bazë 1990)
Armenia	46	46	0%
Austria	194	107	-45%
Bjellorusia	285	255	-11%
Belgjika	339	181	-47%
Bullgaria	361	266	-26%

Kanadaja ^{a1)}	2104		
Kroacia	87	87	0%
Qipro ^{d1)}	18	23	28%
Republika Çeke	742	286	-61%
Danimarka	282	127	-55%
Finlanda	300	170	-43%
Franca	1882	860	-54%
Gjermania	2693	1081	-60%
Greqia	343	344	0%
Hungaria	238	198	-17%
Irlanda	115	65	-43%
Italia	1938	1000	-48%
Letonia	93	84	-10%
Lihtenshtajni	0.63	0.37	-41%
Lituania	158	110	-30%
Luksemburgu	23	11	-52%
Holanda	580	266	-54%
Norvegjia	218	156	-28%
Polonia	1280	879	-31%
Portugalia	348	260	-25%
Republika e Moldovës	100	90	-10%
Rumania	546	437	-20%
Federata Ruse ^{b1)}	3600		
PEMA	360	265	-26%
Sllovakia	225	130	-42%
Sllovenia	62	45	-27%
Spanja ^{b1)}	1113	847	-24%
Suedia	338	148	-56%
Zvicra	166	79	-52%
Ukraina	1880	1222	-35%
Anglia	2673	1181	-56%
Shtetet e Bashkuara të Amerikës ^{c1)}			
Komuniteti Europian	13161	6671	-49%

^{a1)} Pas ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë protokoll, Kanadaja do të paraqesë nivelet e emetimeve për vitin 1990 dhe tavanet e emetimeve për 2010 për oksidet e azotit, qoftë në nivel kombëtar ose për PEMA-n e saj për oksidet e azotit, nëse ka paraqitur një të tillë.

^{b1)} Shifrat aplikohen për pjesën europiane brenda zonës EMEP.

^{c1)} Pas ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë protokoll, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të parashikojnë përfshirjen në këtë aneks: a) të masave për reduktimin e emetimeve specifike të oksideve të azotit, të zbatueshme për burimet e lëvizshme dhe të palëvizshme që do të zbatohet, ose në nivel kombëtar ose brenda një PEMA, nëse është paraqitur një PEMA e oksideve të azotit për t'u përfshirë në aneksin III; b) një vlerë për nivelet e përgjithshme të llogaritura të emetimeve të oksidit të azotit për vitin 1990, ose kombëtare ose për PEMA-n; c) një vlerë treguese për nivelet e përgjithshme të emetimeve të oksidit të azotit për vitin 2010, ose kombëtare ose për PEMA-n; dhe d) vlerësime që lidhen me uljen e përqindjes në emetimet e oksidit të azotit. Pika (b) do të përfshihet në tabelë dhe pikat (a), (c) dhe (d) do të përfshihen në një shënim në tabelë.

^{d1)} Shifrat për Qipron, miratuar në sesionin e 23-të të organit ekzekutiv.



TABELA 3
TAVANET E EMETIMEVE PËR AMONIAKUN (MIJË TON NH₃ NË VIT)

Palët	Nivelet e emetimeve 1990	Tavanet e emetimeve për vitin 2010	Zvogëlimi i emetimeve në përqindje për vitin 2010 (viti bazë 1990)
Armenia	25	25	0%
Austria	81	66	-19%
Bjellorusia	219	158	-28%
Belgjika	107	74	-31%
Bullgaria	144	108	-25%
Kroacia	37	30	-19%
Qipro ^{b2)}	7	9	29%
Republika Çeke	156	101	-35%
Danimarka	122	69	-43%
Finlanda	35	31	-11%
Franca	814	780	-4%
Gjermania	764	550	-28%
Greqia	80	73	-9%
Hungaria	124	90	-27%
Irlanda	126	116	-8%
Italia	466	419	-10%
Letonia	44	44	0%
Lihtenshtajni	0.15	0.15	0%
Lituania	84	84	0%
Luksemburgu	7	7	0%
Hollanda	226	128	-43%
Norvegjia	23	23	0%
Polonia	508	468	-8%
Portugalia	98	108	10%
Republika e Moldovës	49	42	-14%
Rumania	300	210	-30%
Federata Ruse ^{a2)}	1191		
PEMA	61	49	-20%
Sllovakia	62	39	-37%
Sllovenia	24	20	-17%
Spanja ^{a2)}	351	353	1%
Suedia	61	57	-7%
Zvicra	72	63	-13%
Ukraina	729	592	-19%
Mbretëria e Bashkuar	333	297	-11%
Komuniteti Europian	3671	3129	-15%

^{a2)} Shifrat aplikohen për pjesën europiane brenda zonës EMEP.

^{b2)} Shifrat për Qipron, miratuar në sesionin e 23-të të organit ekzekutiv.

TABELA 4
TAVANET E EMETIMEVE PËR KOMPONIMET ORGANIKE TË PAQËNDRUESHME
(MIJË TON VOC NË VIT)

Pala	Nivelet e emetimeve 1990	Tavanet e emetimeve për 2010	Zvogëlimi i emetimeve në përqindje për vitin 2010 (viti bazë 1990)
Armenia	81	81	0%
Austria	351	159	-55%
Bjellorusia	533	309	-42%
Belgjika	324	144	-56%
Bullgaria	217	185	-15%
Kanadaja ^{a3)}	2880		
Kroacia	105	90	-14%
Qipro ^{d3)}	18	14	-22%
Republika Çeke	435	220	-49%
Danimarka	178	85	-52%
Finlanda	209	130	-38%
Franca	2957	1100	-63%
Gjermania	3195	995	-69%
Greqia	373	261	-30%
Hungaria	205	137	-33%
Irlanda	197	55	-72%
Italia	2213	1159	-48%
Letonia	152	136	-11%
Lihtenshtajni	1.56	0.86	-45%
Lituania	103	92	-11%
Luksemburgu	20	9	-55%
Holanda	502	191	-62%
Norvegjia	310	195	-37%
Polonia	831	800	-4%
Portugalia	640	202	-68%
Republika e Moldovës	157	100	-36%
Rumania	616	523	-15%
Federata Ruse ^{a2)}	3566		
PEMA	203	165	-19%
Sllovakia	149	140	-6%
Sllovenia	42	40	-5%
Spanja ^{a2)}	1094	669	-39%
Suedia	526	241	-54%
Zvicra	292	144	-51%
Ukraina	1369	797	-42%
Mbretëria e Bashkuar	2555	1200	-53%
Shtetet e Bashkuara të Amerikës ^{c3)}			
Komuniteti European	15353	6600	-57%

^{a3)} Pas ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë protokoll, Kanadaja do të paraqesë nivelet e emetimeve të vitit 1990 dhe tavanet e emetimeve 2010 për komponimet organike të paqëndrueshme, ose në nivel kombëtar ose për PEMA-n e saj për komponimet organike të paqëndrueshme, nëse ka paraqitur një të tillë.



^{b3)} Shifrat aplikohen për pjesën europiane brenda zonës EMEP.

^{c3)} Pas ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit të këtij protokollit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të ofrojnë për përfshirjen në këtë shtojcë: a) masat për reduktimin e emetimeve specifike të komponimeve organike të paqëndrueshme të zbatueshme për burimet e lëvizshme dhe të palëvizshme që do të zbatohen ose në shkallë kombëtare ose brenda një PEMA, nëse ajo ka paraqitur një PEMA për komponimet organike të paqëndrueshme për përfshirje në aneksin III; b) një vlerë për nivelet e përgjithshme të llogaritura të emetimeve të përbërësve organikë të paqëndrueshëm për vitin 1990, ose kombëtare ose për PEMA-n; c) një vlerë treguese për nivelet e emetimeve të përgjithshme për komponimet organike të paqëndrueshme për vitin 2010, ose kombëtare ose për PEMA-n; dhe d) vlerësime shoqëruese që lidhen me uljen e përqindjes në emetimet për komponimet organike të paqëndrueshme. Pika “b” do të përfshihet në tabelë dhe pikat “a”, “c” dhe “d” do të përfshihen në një shënim në tabelë.

^{d3)} Shifrat për Qipron, miratuar në sesionin e 23-të të organit ekzekutiv.

ANEKSI III

ZONA E MENAXHIMIT TË EMETIMEVE TË NDOTËSVE TË CAKTUAR (PEMA)

PEMA në vijim është regjistruar, për qëllimin e këtij protokollit:
PEMA e Federatës Ruse

Kjo është zona e Murmansk oblast, Republika e Karelia-s, Leningrad oblast (duke përfshirë St. Petersburg), Pskov oblast, Novgorod oblast dhe Kaliningrad oblast. Kufiri i PEMA-s përputhet me shtetin dhe kufijtë administrativë të këtyre njësive përbërëse të Federatës Ruse.

ANEKSI IV

VLERAT KUFI PËR EMETIMET E SQUFURIT NGA BURIMET E PALËVIZSHME

1. Seksioni A zbatohet për palët përveç Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, seksioni B zbatohet për Kanadanë dhe seksioni C zbatohet për Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

A. Palët përveç Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës

2. Për qëllime të seksionit A, përveç tabelës 2 dhe paragrafëve 11 dhe 12, vlera kufi do të thotë sasia e një substance të gaztë në përmbajtje të gazrave të mbetura nga një instalim, vlerë që nuk duhet të tejkalohet. Përveç kur përcaktohet ndryshe, ajo do të llogaritet në aspektin e masës të një ndotësi për volumin e gazrave të mbetura (i shprehur në mg/m³), duke supozuar kushtet standarde për temperaturën dhe presionin për gazin e thatë (vëllim me 273, 15 K, 101,3 kPa). Për sa i përket përmbajtjes së oksigjenit në gazrat e shkarkimeve, do të aplikohen vlerat e dhëna në tabelat më poshtë për secilën kategori burimi. Hollimi me qëllim zvogëlimin e përqendrimeve të ndotësve në gazrat e shkarkimeve nuk lejohet. Hapja, mbyllja dhe mirëmbajtja e pajisjeve janë përjashtuar.

3. Emetimet do të monitorohen¹ në të gjitha rastet. Pajtueshmëria me vlerat kufi do të verifikohet. Metodatat e verifikimit mund të përfshijnë matjet e vazhduara apo të ndërprera, të miratuara, ose çdo metodë tjetër teknike të sigurt.

4. Përzgjedhja e mostrave dhe analiza e ndotësve, si dhe metodatat referuese të matjeve për kalibrimin e një sistemi të matjes, do të kryhet në përputhje me standardet e përcaktuara nga Komisioni Europian për Standardizim (CEN) ose nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO). Në pritje të zhvillimit të standardeve CEN ose ISO, do të zbatohen standardet kombëtare.

¹ Shënim. Monitorimi duhet kuptuar si një aktivitet i përgjithshëm, i përbërë nga matja e emetimeve, balancimi i masës etj. Ai mund të kryhet në mënyrë të vazhdueshme ose të ndërprerë.

5. Matjet e emetimeve duhet të kryhen në vazhdimësi kur emetimet e SO₂ tejkalojnë 75 kg/orë.

6. Në rastin e matjes së vazhdueshme për impiantin e ri, përputhja me standardet e emetimeve është arritur nëse vlerat mesatare ditore të llogaritura nuk tejkalojnë vlerën kufi dhe nëse asnjë vlerë për orë nuk tejkalon vlerën kufi me 100%.

7. Në rastin e matjeve të vazhdueshme për impiantin ekzistues, pajtueshmëria me standardet e emetimeve është arritur nëse: a) asnjë nga vlerat mesatare mujore nuk tejkalon vlerat kufi; dhe b) 97% e të gjithë vlerave mesatare 48-orëshe nuk tejkalojnë vlerat kufi me 110%.

8. Në rastin e matjeve të ndërprera, si një kërkesë minimale, pajtueshmëria me standardet e emetimeve është arritur nëse vlera mesatare e bazuar në një numër të përshtatshëm matjesh në kushte përfaqësuese, nuk tejkalon vlerën e standardit të emetimit.

9. Kaldajat dhe ngrohësit me djegie me prodhim nominal termik që tejkalojnë vlerën 50 MWth

TABELA 1
VLERAT KUFI PËR EMETIMET E SOX TË ÇLIRUARA NGA KALDAJAT ^{a)}

	Prodhimi termik (MWth)	Vlera kufi (mg SO₂/Nm³)^{b)}	Alternativa për efikasitetin e largimit të lëndëve djegëse të ngurta kombëtare
Lëndët djegëse të ngurta dhe të lëngëta, instalime të reja	50 - 100	850	90% ^{d)}
	100 - 300	850 - 200 ^{c)} (ulje lineare)	92% ^{d)}
	> 300	200 ^{c)}	95% ^{d)}
Lëndët djegëse të ngurta, instalimet ekzistuese	50 -100	2000	
	100 - 500	2000 - 400 (ulje lineare)	
	> 500	400	
	50 - 150		40%
	150 - 500		40 - 90% (rritje lineare)
	> 500		90%
Lëndët djegëse të lëngëta, instalimet ekzistuese	50 - 300	1700	
	300 - 500	1700 - 400 (ulje lineare)	
	> 500	400	
Lëndët djegëse të gazta në përgjithësi, instalime të reja dhe ekzistuese		35	
Gazra të lëngëzuara, instalime të reja dhe ekzistuese		5	
Gazra me vlerë të ulët kalorifike (p.sh. gazifikimi i mbetjeve të rafinerisë apo djegia e gazit të furrës koks)		të reja 400 ekzistuese 800	
Gazet e furrave të shkrirjes		të reja 200 ekzistuese 800	
Impiante të reja djegieje në rafineri	> 50 (kapaciteti total i rafinerisë)	600	



(mesatarja e të gjitha instalimeve të reja me djegie)			
Impiante ekzistuese djegieje në rafineri (mesatarja e të gjitha instalimeve ekzistuese me djegie)		1000	

- a) Në veçanti, vlerat kufi nuk do të zbatohen për:
- impiantet në të cilat produktet e djegies përdoren për ngrohje direkte, tharje apo çdo trajtim tjetër të objekteve ose materialeve, p.sh. furrat ringrohëse, furrat për trajtimin e nxehtësisë;
 - impiante pasdjegies, d.m.th. aparate teknike të projektuara për të pastruar me djegie gazrat e mbetura që nuk operojnë si një impiant i pavarur për djegie;
 - pajisje për rigjenerimin e katalizatorëve katalitikë të krekingut;
 - pajisje për shndërrimin e sulfurit të hidrogjenit në sqfur;
 - reaktorët që përdoren në industrinë kimike;
 - furrat bateri të koksit;
 - Cowpers;
 - furrat për djegien e mbetjeve; dhe
 - impiante të pajisur me motorë dizel, benzinë apo gaz ose me turbina me djegie, pavarësisht nga lëndët djegëse që përdorin.
- b) Përmbajtja referuese e O₂ është 6% për lëndët djegëse të ngurta dhe 3% për të tjerat.
- c) 400 me lëndë djegëse të rënda S < 0,25 %.
- d) Nëse një instalim arrin 300 mg/Nm³ SO₂, ai mund të përjashtohet nga aplikimi për efikasitetin e largimit.

10. Lëndë djegëse e gaztë

TABELA 2

VLERAT KUFI PËR PËRMBAJTJEN E SQFURIT NË LËNDË DJEGËSE TË GAZTË ^{a)}

	Përmbajtja e sqfurit (në përqindje peshë)
Lëndë djegëse e gaztë	< 0.2 pas 1 korrikut 2000 < 0.1 pas 1 janarit 2008

a) “Lëndë djegëse e gaztë” do të thotë çdo produkt i naftës që bën pjesë në HS 2710, ose çdo produkt i naftës i cili, për arsye të kufijve të tij të distilimit, bie në kategorinë e distilateve të mesëm të destinuar për përdorim si lëndë djegëse dhe prej të cilave së paku 85 për qind në vëllim distillojnë në 350°C, duke përfshirë edhe humbjet në distilim. Lëndët djegëse që përdoren në automjetet rrugore dhe jorugore dhe traktorët bujqësorë janë të përjashtuar nga ky përkufizim. Lënda djegëse e gaztë që përdoret për qëllime detare është përfshirë në përkufizim nëse plotëson përshtatimin më sipër, ose ka një densitet ose viskozitet që përfshihet në nivelin e viskozitetit ose densitetit për distilatet detare të përcaktuara në tabelën I të ISO 8217 (1996).

11. Impiantet Klaus: për impiantin që prodhon më shumë se 50 Mg sqfur në ditë:

- a) rikuperimi i sqfurit 99,5% për një impiant të ri;
- b) rikuperimi i sqfurit 97% për një impiant ekzistues.

12. Prodhimi i dyoksidit të titanit: në instalimet e reja dhe ekzistuese, shkarkimet nga fazat e disgregimit dhe pjekjes në prodhimin e dyoksidit të titanit do të reduktohen në një vlerë prej jo më shumë se 10 kg të SO₂ të barazvlefshme për Mg të dyoksidit të titanit të prodhuar.

B. Kanadaja

13. Vlerat kufi për kontrollin e emetimeve të dyoksidit të squfurit nga burime të reja të palëvizshme në kategorinë e mëposhtme të burimit të palëvizshëm do të përcaktohet në bazë të informacionit në dispozicion për teknologjinë dhe nivelet e kontrollit, duke përfshirë vlerat kufi të zbatuara në vende të tjera dhe në dokumentin e mëposhtëm:

Gazeta Kanada, Pjesa I. Departamenti i Mjedisit. Emetimet në prodhimin e energjisë termike – udhëzime kombëtare për burime të reja të palëvizshme, 15 maj 1993, fq. 1633-1638.

C. Shtetet e Bashkuara të Amerikës

14. Vlerat kufi për kontrollin e emetimeve të dyoksidit të squfurit nga burime të reja të palëvizshme në kategoritë e mëposhtme të burimit të palëvizshëm, përcaktohen në dokumentet e mëposhtme:

a) Njësitë e prodhimi të avullit në dobi të elektricitetit-Kodi 40 i Rregullores Federale (CFR) pjesa 60, nënpjesa D, dhe nënpjesa Da;

b) Njësitë e prodhimit të avullit industrial-komercial-institucional - CFR 40, pjesa 60, nënpjesa Db, dhe nënpjesa Dc;

c) Impiante të acidit sulphurik-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa H;

d) Rafineritë e naftës-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa J;

e) Shkrirësit primare të bakrit- CFR 40, pjesa 60, nënpjesa P;

f) Shkrirësit primarë të zinkut-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa Q;

g) Shkrirësit primarë të plumbit-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa R;

h) Turbinat e palëvizshme me gaz-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa GG;

i) Përpunimi tokësor i gazit natyror-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa LLL;

j) Djegia e mbetjeve komunale-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa Ea, dhe nënpjesa Eb; dhe

k) Furrat e djegies së mbetjeve spitalore/mjekësore/infektive - CFR 40, pjesa 60, nënpjesa

Ec.

ANEKS V

VLERAT KUFI PËR EMETIMET E OKSIDEVE TË AZOTIT NGA BURIMET E PALËVIZSHME

1. Seksioni A zbatohet për palët përveç Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, seksioni B zbatohet në Kanada dhe seksioni C zbatohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

A. Palët e tjera përveç Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës

2. Për qëllime të seksionit A, vlera kufi do të thotë sasia që nuk duhet të tejkalohet e një substance të gaztë që përmbahet në gazrat e mbetjeve nga një instalim. Përveç kur përcaktohet ndryshe, ajo do të llogaritet në aspektin e masës së një ndotësi në volumin e gazrave të shkarkimeve (të shprehura në mg/m³), duke supozuar kushte standarde të temperaturës dhe presionin për gazin e thatë (volumi në 273,15 K, 101,3 kPa). Për sa i përket përmbajtjes së oksigjenit në gazrat e shkarkimeve, do të zbatohen vlerat e dhëna në tabelat më poshtë për secilën kategori burimi. Nuk lejohet hollimi me qëllim zvogëlimin e përqendrimeve të ndotësve në gazrat e mbetura. Vlerat kufi në përgjithësi i referohen NO së bashku me NO₂, i quajtur zakonisht NO_x, të shprehura si NO₂. Hapja, mbyllja dhe mirëmbajtja e pajisjeve janë të përjashtuara.

3. Emetimet do të monitorohen¹ në të gjitha rastet. Pajtueshmëria me vlerat kufi do të verifikohet. Metodatat e verifikimit mund të përfshijnë matje të vazhdueshme apo të ndërprera, të miratuara ose çdo metodë tjetër teknikisht të pranueshme.

¹ Shënim. Monitorimi duhet kuptuar si një aktivitet i përgjithshëm që përfshin matjet e emetimeve, balancimin e masës etj. Mund të kryhet në mënyrë të vazhduar ose të ndërprerë.



4. Përzgjedhja e mostrave dhe analiza e ndotësve, si dhe metodat referuese të matjes për kalibrimin e një sistemi të matjes, do të kryhen në përputhje me standardet e përcaktuara nga Komisioni Europian për Standardizim (CEN) ose nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO). Në pritje të zhvillimit të standardeve CEN dhe ISO, do të zbatohen standardet kombëtare.

5. Matjet e emetimeve do të kryhen në vazhdimësi kur emetimet e NOx tejkalojnë 75kg/orë.

6. Në rastin e matjeve të vazhdueshme, me përjashtim të impianteve ekzistuese të djegies të paraqitura në tabelën 1, pajtueshmëria me standardet e emetimeve është arritur nëse vlera mesatare ditore e llogaritur nuk tejkalon vlerën kufi dhe nëse asnjë vlerë për orë nuk kalon vlerën kufi me 100%.

7. Në rastin e matjeve të vazhdueshme për impiantet ekzistuese të djegies të paraqitura në tabelën 1, pajtueshmëria me standardet e emetimeve është arritur nëse: a) asnjë nga vlerat mesatare mujore nuk tejkalon vlerat kufi të emetimeve; dhe b) 95% e të gjitha vlerave mesatare 48-orëshe nuk tejkalon 110% të vlerave kufi të emetimeve.

8. Në rastin e matjeve të ndërprera, si një kërkesë minimale, pajtueshmëria me standardet e emetimeve është arritur nëse vlera mesatare bazuar në një numër të përshtatshëm matjesh në kushte përfaqësuese nuk tejkalon vlerën e standardit të emetimit.

9. Kaldajat dhe ngrohësit me djegie me një prodhim nominal termik që tejkalon 50 MWth

TABELA 1

VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NOX TË ÇLIRUARA NGA KALDAJAT ^{a)}

	Vlera limite (mg/m ³) ^{b)}
Lëndë djegëse e ngurtë, instalimet e reja:	
- Kaldajat 50-100 MWth	400
- Kaldajat 100 - 300 MWth	300
- Kaldajat > 300MWth	200
Lëndë djegëse të ngurta, instalimet ekzistuese:	
Lëndë djegëse të ngurta në përgjithësi	650
Lëndë djegëse të ngurta me më pak se 10% komponime të paqëndrueshme	1300
Lëndë djegëse të lëngëta, instalime të reja	
- Kaldajat 50-100 MWth	400
- Kaldajat 100 - 300 MWth	300
- Kaldajat > 300 MWth	200
Lëndë djegëse të lëngëta, instalimet ekzistuese	450
Lëndë djegëse të gazta, instalime të reja:	
Lëndë djegëse: gaz natyror	
- Kaldajat 50 - 300 MWth	150
- Kaldajat > 300 MWth	100
Lëndë djegëse: të gjithë gazet e tjerë	200
Lëndë djegëse të gazta, instalimet ekzistuese	350

^{a)} Në mënyrë të veçantë, vlerat kufi nuk do të zbatohen për:

- impiante në të cilat produktet e djegies janë përdorur për ngrohje direkte, tharje, apo çdo trajtim tjetër të objekteve ose të materialeve, p.sh. furrat ringrohëse, furrat për trajtimin e nxehtësisë;

- impiante pas-djegies, d.m.th aparate teknike të projektuara për të pastruar me djegie gazet e mbetura por që nuk operojnë si një impiant i pavarur për djegie;

- pajisje për rigjenerimin e katalizatorëve katalitikë të krekingut;
- pajisje për shndërrimin e sulfurit të hidrogjenit në sqfur;
- reaktorët që përdoren në industrinë kimike;
- furrat bateri të koksit;
- Cowpers;
- incineratorët e mbetjeve; dhe
- impiante të pajisur me motorë dizel, benzinë apo gaz ose me turbina me djegie, pavarësisht nga lëndët djegëse që përdorin.

^{b)} Këto vlera nuk aplikohen për kaldaja me kapacitet më pak se 500 orë në vit. Përmbajtja e O₂ referues është 6% për lëndët djegëse të ngurta dhe 3% për të tjerat.

10. Turbinat tokësore me djegie me kapacitet nominal termik që tejkalon 50 MWth
Vlerat kufi të NO_x të shprehura në mg/Nm³ (me një përmbajtje O₂ prej 15%) do të aplikohen për një turbinë të vetme. Vlerat kufi në tabelën 2 zbatohen vetëm mbi 70% të ngarkesës.

TABELA 2
VLERAT KUFIT PËR EMETIMET E NO_x TË ÇLIRUARA NGA TURBINAT TOKËSORE
ME DJEGIE

> 50 MWth (kapaciteti termik në kushtet e ISO)	Vlera kufi (mg/Nm ³)
Instalime të reja, gazi natyror ^{a)}	50 ^{b)}
Instalime të reja, lëndë djegëse të lëngshme ^{c)}	120
Instalimet ekzistuese, të gjitha lëndët djegëse ^{d)}	
- Gaz natyror	150
- Lëngjet	200

^{a)} Gazi natyror është gazi metan që ndodhet në natyrë me jo më shumë se 20% (në volum) inerte dhe përbërës të tjerë.

^{b)} 75 mg/Nm³, nëse është:

- turbinë me djegie që përdoret në një sistem të kombinuar të ngrohjes dhe energjisë; ose
- kompresor me turbinë me djegie për rrjetin e furnizimit publik me gaz.

Për turbinat me djegie që nuk klasifikohen në kategoritë e mësipërme por që kanë një efikasitet më të madh se 35%, i përcaktuar në kushtet ISO të ngarkesës bazë, vlera kufi do të jetë 50^{*}n) 35 ku “n” është rendimenti i djegies së turbinës i shprehur në përqindje (dhe i përcaktuar në kushtet e ngarkesës bazë ISO).

^{c)} Kjo vlerë kufi zbatohet vetëm për turbinat me djegie që djegin distilate të lehta dhe të mesme.

^{d)} Vlerat kufi nuk zbatohen për turbinat me djegie me kapacitet më pak se 150 orë në vit.

11. Prodhimi i çimentos

TABELA 3
VLERAT KUFIT PËR EMETIMET E NO_x TË ÇLIRUARA NGA PRODHIMI I ÇIMENTOS ^{a)}

	Vlera kufi (mg/Nm ³)
Instalime të reja (O ₂ 10%)	
- Furrat e tharjes	500
- Furrat e tjera	800
Instalimet ekzistuese (O ₂ 10%)	1200

^{a)} Instalime për prodhimin e çimentos të pakalcinuar në furrat rrotulluese me një kapacitet > 500 Mg/ditë ose në furra të tjera me një kapacitet > 50 Mg/ditë.



12. Motorë të palëvizshëm

TABELA 4

VLERAT KUFI PËR NOX E ÇLIRUAR NGA MOTORËT E RINJ TË PALËVIZSHËM

Kapaciteti, teknika, specifikimi i lëndës djegëse	Vlera kufi (kufi) ^{a)} (mg/Nm ³)
Motorët me ndezje (= Otto) me shkëndijë, me 4- kohë, > 1 MWth	
- Motorët me djegie të ulët	250
- Të gjithë motorët e tjerë	500
Motorët me ndezje me kompresion (= Diesel), > 5 MWth	
Lënda djegëse: gazi natyror (motorë me ndezje reaktive)	500
Lënda djegëse: lëndë djegëse e rëndë	600
Lënda djegëse: lëndë djegëse dizel ose gaz	500

^{a)} Këto vlera nuk aplikohen për motorët me kapacitet më pak se 500 orë në vit. Përmbajtja referuese e O₂ është 5%.

13. Prodhimi dhe përpunimi i metaleve

TABELA 5

VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NOX TË ÇLIRUARA NGA PRODHIMI PRIMAR I HEKURIT DHE ÇELIKUT ^{a)}

Kapaciteti, teknika, specifikimi i lëndës djegëse	Vlera kufi (mg/Nm ³)
Impiantet e reja dhe ekzistuese të skorjes	400

^{a)} Prodhimi dhe përpunimi i metaleve: instalimet për pjekjen e xeherorit të metalit ose skorjes, instalimet për prodhimin e gizes ose çelikut (shkrirja primare ose sekondare), duke përfshirë derdhjen e vazhduar me një kapacitet që tejkalon 2,5 Mg/orë, instalimet për përpunimin e metaleve ferore (mullinj rrotullues në të nxehtë > 20 Mg/orë për çelikon e papërpunuar).

14. Prodhimi i acidit nitrik

TABELA 6

VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NOX TË ÇLIRUARA NGA PRODHIMI I ACIDIT NITRIK, DUKE PËRJASHTUAR IMPIANTET E PËRQENDRIMIT TË ACIDIT

Kapaciteti, teknika, specifikimi i lëndës djegëse	Vlera kufi (mg/Nm ³)
- Instalimet e reja	350
- Instalimet ekzistuese	450

B. Kanadaja

15. Vlerat kufi për kontrollin e emetimeve të oksideve të azotit (NO_x), nga burimet e reja të palëvizshme në kategoritë e mëposhtme të burimit të palëvizshëm do të përcaktohen në bazë të informacionit në dispozicion për teknologjinë e kontrollit dhe niveleve, duke përfshirë vlerat kufi të aplikuara në vende të tjera dhe në dokumentet e mëposhtme:

a) Këshilli i Ministrave Kanadez i Mjedisit (CCME). Udhëzimet kombëtare të emetimeve për turbinat e palëvizshme për djegie. Dhjetor 1992. PN1072;

b) Gazeta Kanada, pjesa I. Departamenti i Mjedisit. Emetimet e prodhimit të energjisë termike - Udhëzime kombëtare për burime të reja të palëvizshme. 15 Maj 1993, fq. 1633-1638, dhe

c) CME. Udhëzimet kombëtare të emetimeve për furrat e çimentos. Mars 1998. PN1284.

C. Shtetet e Bashkuara të Amerikës

16. Vlerat kufi për kontrollin e emetimeve të NO_x nga burimet e reja të palëvizshme në kategorinë e mëposhtme të burimeve të palëvizshme janë përcaktuar në dokumentet e mëposhtme:

a) Njësitë me ngrohje me qymyr për nevoja komunale-Kodi 40 i Rregullores Federale (CFR) pjesa 76;

b) Njësitë e prodhimit të avullit për nevoja elektrike-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa D, dhe nënpjesa Da;

c) Njësitë e prodhimit të avullit industrial-komercial-institucional-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa Db;

d) Impiantet e acidit nitrik-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa G;

e) Turbinat e palëvizshme me gaz-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa GG;

f) Impiantet e djegies së mbeturinave komunale-40 CFR pjesa 60, nënpjesa Ea, dhe nënpjesa Eb; dhe

g) Furrat për djegien e mbetjeve spitalore/mjekësore/infektive-40 CFR pjesa 60, nënpjesa Ec.

ANEKSI VI

VLERAT KUFI PËR EMETIMET E KOMPONIMEVE ORGANIKE TË PAQËNDRUESHME NGA BURIMET E PALËVIZSHME

1. Seksioni A zbatohet për palët përveç Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, seksioni B zbatohet në Kanada dhe seksioni C zbatohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

A. Palët përveç Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës

2. Ky seksion i këtij aneksi mbulon burimet e palëvizshme të shkarkimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme të jometaneve (NMVOC) që paraqiten në paragrafët 8-21 më poshtë. Këtu nuk mbulohen instalimet ose pjesë të instalimeve për kërkime shkencore, për zhvillime dhe testime të produkteve dhe proceseve të reja. Vlerat prag janë dhënë në tabelat e sektorëve specifike më poshtë. Ato në përgjithësi i referohen konsumit të tretësve apo rrjedhjes në masë të emetimeve. Kur një operator kryen disa aktivitete që janë në të njëjtin nëntitull në instalime të njëjta në të njëjtën vendndodhje, konsumi i tretësve ose rrjedhja në masë e emetimeve në këto aktivitete mbledhen së bashku. Nëse nuk ka të shprehur ndonjë vlerë pragu, zbatohet vlera kufi e dhënë për të gjitha këto instalime.

3. Për qëllime të seksionit A, në këtë aneks:

a) “Ruajtja dhe shpërndarja e benzinës” do të thotë ngarkesa e kamionëve, vagonëve të hekurudhave, maunave dhe anijeve detare në depot dhe stacionet e shpërndarjes së lëndëve djegëse minerale, me përjashtim të furnizimit të automjeteve me karburant në stacionet e shërbimit që mbulohen nga dokumentet përkatëse për burimet e lëvizshme.

b) “Shtresë ngjitëse” nënkupton çdo proces në të cilin një ngjitës është aplikuar në një sipërfaqe, me përjashtim të veshjes ngjitëse dhe laminimit në proceset e shtypjes (printimit) dhe petëzimit të drurit dhe plastikëve.

c) “Petëzimi i drurit dhe plastikëve” nënkupton çdo proces që bashkon dru dhe/ose plastikë për të prodhuar produkte të laminuara.

d) “Proceset e veshjes” nënkupton aplikimin e sipërfaqeve metalike dhe plastike në makinat e pasagjerëve, kabinat e kamionëve, kamionë, autobusë apo sipërfaqe prej druri dhe mbulon çdo



proces në të cilin me një aplikim të vetëm ose të shumëfishtë është hedhur mbi to një veshje me shtresë të vazhduar filmi në:

i) automjetet e reja të përcaktuara (shih më poshtë) si automjete të kategorisë M1 dhe të kategorisë N1 kur ato janë veshur në të njëjtin instalim si automjetet M1;

ii) kabinat e kamionëve, të përcaktuara si strehim për shoferë, dhe të gjitha strehimet e integruara për pajisjet teknike të automjeteve të kategorisë N2 dhe N3;

iii) furgonë dhe kamionë të përcaktuar si automjete të kategorisë N1, N2 dhe N3, por duke përjashtuar kabinat e kamionëve;

iv) autobusët e përcaktuar si automjete të kategorisë M2 dhe M3; dhe

v) sipërfaqe të tjera metalike dhe plastike, duke përfshirë ato të avionëve, anijeve, trenave etj., sipërfaqet e drurit, tekstileve, pëlhurave, film dhe letër.

Kjo kategori burimi nuk përfshin veshjen e nënshtresave me metale, me anën e teknikave të spërkatjes elektroforetike ose kimike. Nëse procesi i veshjes përfshin një stad në të cilin i njëjti artikull është shtypur (printuar), ky stad i shtypjes (printimit) konsiderohet pjesë e procesit të veshjes. Megjithatë, proceset e shtypjes (printimit) që funksionojnë si aktivitete të veçanta nuk janë të përfshira. Në këtë përkufizim:

- Automjete M1 janë ato automjete që përdoren për transportin e udhëtarëve dhe që kanë jo më shumë se tetë vende përveç vendit të shoferit;

- Automjete M2 janë ato automjete që përdoren për transportin e udhëtarëve dhe që kanë më tepër se tetë vende përveç vendit të shoferit, dhe që kanë një masë maksimale që nuk i kalon 5 Mg;

- Automjete M3 janë ato automjete që përdoren për transportin e udhëtarëve dhe që kanë më tepër se tetë vende përveç vendit të shoferit, dhe që kanë një masë maksimale që i kalon 5 Mg;

- Automjete N1 janë ato automjete që përdoren për transportin e mallrave dhe që kanë një masë maksimale që nuk i kalon 3,5 Mg;

- Automjete N2 janë ato automjete që përdoren për transportin e mallrave dhe që kanë një masë maksimale që tejkalon 3,5 Mg, por që nuk tejkalon 12 Mg;

- Automjete N3 janë ato që përdoren për transportin e mallrave dhe që kanë një masë maksimale që tejkalon 12 Mg.

e) “Veshje spirale” nënkupton çdo proces ku çeliku i petëzuar, çeliku inoks, çeliku i veshur, aliazhe të bakrit apo rripa alumini janë të mbuluar me një shtresë ose një filmi ose veshje të petëzuar në një proces të vazhduar.

f) “Pastrim kimik” nënkupton çdo proces industrial ose komercial që përdor VOC në një instalim për pastrimin e veshjeve, orendive dhe mallrave të ngjashme të konsumit, me përjashtim të heqjes me dorë të njollave dhe pikave në industrinë tekstile dhe të veshjes.

g) “Prodhim i veshjeve, llaqeve, ngjyrave dhe ngjitësve” nënkupton prodhimin e veshjeve të përgatitura, llaqeve, ngjyrave dhe ngjitësve, dhe i produkteve të ndërmjetëm derisa ato të jenë prodhuar në të njëjtin instalim nga përzierja e pigmenteve, rrëshirave dhe materialeve ngjitëse me tretësit organikë ose mbartës të tjerë.

Kjo kategori gjithashtu përfshin dispersionin, paradispersionin, realizimin e një viskoziteti ose ngjyrë të caktuar dhe paketimin e produkteve përfundimtare në kontejnerë.

h) “Printimi” (shtypja) nënkupton çdo proces të riprodhimit të tekstit dhe/ose imazhit në të cilin, me përdorimin e një mbartësi imazhi, ngjyra transferohet në një sipërfaqe dhe aplikohet për nënproceset e mëposhtme:

i) Fleksografi: një proces shtypje (printimi) duke përdorur një mbartës imazhi prej gome ose fotopolimeri elastik në të cilin bojërat e shtypjes (printimit) janë mbi zonat jo të shtypura (printuara), duke përdorur bojëra të lëngshme që thahen me anë të avullimit;

ii) Ngjyrosja e materialeve në të nxehtë: një proces printimi letërushqyes duke përdorur një mbartës imazhi në të cilin zonat për printim (shtyp) dhe jo për printim (shtyp) janë në të njëjtin plan,

ku ushqimi i letrës do të thotë se materiali për t'u shtypur është kaluar në makinë nga një bobinë në mënyrë të ndarë për fletë të veçanta. Zona jo për shtyp është trajtuar për tërheqjen e ujit dhe në këtë mënyrë nuk lejon bojën. Zona për shtyp është trajtuar për të marrë dhe për të transmetuar ngjyrën në sipërfaqen që do të shtypet. Avullimi ndodh në një furrë ku përdoret ajri i nxehtë për të nxehur materialet e shtypura (printuara);

iii) Rotogravurat e botuara: rotogravura e përdorur për shtypjen e letrës për gazeta, revista, broshura, katalogë ose produkte të ngjashme, duke përdorur ngjyrat me bazë tolueni;

iv) Rotogravura: një proces shtypjeje (printimi) duke përdorur një mbartës cilindrik imazhi në të cilin zona për shtyp (printim) është nën zonën jo për shtyp (printim), duke përdorur ngjyra të lëngëta që thahen me avullim. Hapësirat e ndara janë të mbushura me ngjyrë dhe teprica pastrohet nga zona e joprintimit përpara se sipërfaqja që do të printohet të bjerë në kontakt me cilindrin dhe tërheq ngjyrën nga hapësirat e ndara;

v) Printimi me ekran rrotullues: një proces shtypje (printimi) letër-ushqyes në të cilën ngjyra (boja) kalon mbi sipërfaqen që do të printohet nëpërmjet një mbartësi poroz imazhi, në të cilin zona për shtyp (printim) është e hapur dhe zona jo për shtyp(printim) është e mbyllur, duke përdorur ngjyrat (bojërat) e lëngëta që thahen vetëm me anë të avullimit. Letër-ushqyes do të thotë që materiali për të shtypur është kaluar në makinë nga një bobinë në mënyrë të ndarë për fletë të veçanta;

vi) Laminimi që lidhet me një proces shtypje (printimi): ngjitja e dy ose më shumë materialesh fleksibël për të prodhuar laminatet; dhe

vii) Lustrimi: një proces me të cilin llaku apo një shtresë ngjitëse është aplikuar në një material fleksibël, me qëllim që më pas të vendoset në materialet e paketuara.

i) "Prodhimi i produkteve farmaceutike" nënkupton sinteza kimike, fermentime, ekstraktime, formulime dhe përfundimin e produkteve farmaceutike dhe, kur kryhen në të njëjtin vend, prodhimin e produkteve të ndërmjetme.

j) "Konvertimi i një gome natyrale apo sintetike" nënkupton çdo proces të bashkimit, copëtimit, përzierjes, petëzimit, shtrydhjes dhe vullkanizimit të gomës natyrale apo sintetike, si dhe proceset e përpunimit të gomës natyrale apo sintetike për të nxjerre një produkt përfundimtar.

k) "Pastrimi i sipërfaqes" nënkupton çdo proces, përveç pastrimit kimik, që përdor tretës organikë për të hequr ndotjet nga sipërfaqja e materialit, duke përfshirë dhe sgrasatimin; procesi i pastrimit që përbëhet nga më shumë se një stad para ose pas një stadi tjetër përpunimi konsiderohet si një proces i vetëm i pastrimit të sipërfaqes. Procesi i referohet pastrimit të sipërfaqes së produkteve dhe jo pastrimit të pajisjeve të procesit.

l) "Nxjerrja e vajit bimor dhe yndyrave shtazore dhe rafinimi i vajit vegjetal" do të thotë nxjerrja e vajit vegjetal nga farat dhe materiale të tjera bimore, përpunimi i mbetjes së thatë për të prodhuar ushqim për kafshë, dhe pastrimi i yndyrave dhe vajrave bimorë që përftohen nga farat, lëndët bimore dhe/ose lëndët shtazore.

m) "Rafinimi i automjeteve" nënkupton çdo veprimtari veshjeje industriale ose komerciale dhe që shoqërohet me kryerjen e aktiviteteve të sgrasatimit:

i) Veshja e automjeteve rrugore, ose një pjese të tyre, që kryhet si riparim i pjesshëm i automjetit, ruajtje ose dekoracion jashtë instalimeve të prodhimit; ose

ii) Veshja origjinale e automjeteve rrugore, ose një pjese të tyre, me materiale të tipit të refinimit, kur kjo është bërë ndryshe nga linja origjinale e prodhimit; ose

iii) Veshja e rimorkiove (duke përfshirë edhe gjysmërimorkiot).

n) "Mbushje e sipërfaqeve të drurit" do të thotë çdo proces i mbushjes së lëndës së drurit me ruajtës.

o) "Kushtet standarde" do të thotë një temperaturë 273.15 K dhe një presion 101, 3 kPa.



p) “NMVOC” përfshin të gjitha komponimet organike, me përjashtim të metanit, që në 273,15 K paraqesin një presion avullimi jo me pak se 0,01 kPa, ose që paraqesin një paqëndrueshmëri të krahasueshme në kushtet e caktuara të aplikimit.

q) “Gaz i mbetur” nënkupton shkarkimin përfundimtar të gazrave që përmbajnë NMVOC apo ndotës të tjerë nga një oxhak apo nga pajisjet e reduktimit të emetimeve në ajër. Sasitë e rrjedhjes volumetrike duhet të shprehen në m³/orë në kushtet standarde.

r) “Emetimet e NMVOC nga rrjedhjet” nënkupton çdo emetim, jo në gazrat e mbetura, të NMVOC në ajër, tokë dhe ujë, si dhe, nëse nuk shprehet ndryshe, tretësit që përmbahen në çdo produkt dhe përfshijnë emetimet e pakapura të NMVOC-ve të lëshuara në mjedisin e jashtëm nëpërmjet dritareve, dyerve, daljeve dhe daljeve të tjera të ngjashme. Vlerat kufi për rrjedhjet janë llogaritur mbi bazën e një plani të menaxhimit të tretësve (shih shtojcën I në këtë aneks).

s) “Emetim total i NMVOC” nënkupton shumën e emetimit të rrjedhjeve të NMVOC dhe emetimit të NMVOC në gazrat e mbetura.

t) “Input” nënkupton sasinë e tretësit organik dhe sasinë e tyre në përgatitjet e përdorura kur kryhet një proces, duke përfshirë riciklimin e tretësit brenda dhe jashtë instalimit, të cilët numërohen çdo herë që janë përdorur për kryerjen e aktivitetit.

u) “Vlerë kufi” nënkupton sasinë maksimale të një substance të gaztë që përmbahet në gazrat e mbetura nga një instalim, vlerë që nuk duhet të tejkalohet gjatë punës normale. Përveç kur përcaktohet ndryshe, ajo do të llogaritet në aspektin e masës së një ndotësi në vëllimin e gazeve të mbetura (e shprehur si mg C/Nm³, përveç kur përcaktohet ndryshe), duke supozuar kushtet standarde të temperaturës dhe presionit për gazin e thatë. Për instalimet që përdorin tretës, vlerat limite janë dhënë si njësi mase për njësinë karakteristike të aktivitetit përkatës. Vëllimet e gazrave që janë shtuar në gazrat e mbetura për ftohje apo qëllime hollimi nuk do të merren parasysh gjatë përcaktimit të përqendrimit të masës ndotëse në gazin e mbetur. Vlerat kufi në përgjithësi i adresohen të gjitha komponimeve organike të paqëndrueshme, me përjashtim të metanit (nuk është bërë dallim i mëtejshëm, p.sh. në kushtet e reaktivitetit ose toksicitetit).

v) “Operimi normal” nënkupton të gjitha periudhat e operimit, me përjashtim të operacioneve të hapjes dhe mbylljes, si dhe mirëmbajtjes së pajisjeve.

w) “Substancat e dëmshme për shëndetin e njeriut” nënndahen në dy kategori:

- i) VOC e halogjenizuara, që kanë mundësinë e rrezikut për ndikime të pakthyeshme, ose
- ii) substancat e rrezikshme që janë kancerogjene, mutagjene ose toksike për riprodhimin ose që mund të shkaktojnë kancer, dëme gjenetike të trashëgueshme, kancer me inhalacion, mund të pengojnë pjellorinë ose mund të shkaktojnë dëme tek fëmijët e palindur.

4. Do të plotësohen kërkesat e mëposhtme:

a) Emetimet e NMVOC do të monitorohen¹ dhe pajtueshmëria me vlerat kufi do të verifikohet. Metodatat e verifikimit mund të përfshijnë matjet e vazhduara apo të ndërprera, metoda të miratuara apo çdo metodë tjetër teknike të vlefshme; për më tepër, metodatat e verifikimit do të jenë ekonomike të zbatueshme.

b) Përqendrimet e ndotësve të ajrit në tubacionet e transportimit të gazeve do të maten në mënyrë përfaqësuese. Përzgjedhja e mostrave dhe analizat e të gjithë ndotësve, si dhe metodatat referuese të matjeve për kalibrimin e sistemit të matjes, do të kryhen sipas standardeve të përcaktuara nga Komisioni Europian për Standardizim (CEN) ose nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO). Në pritje të zhvillimit të standardeve CEN dhe ISO, do të zbatohen standardet kombëtare.

¹ Shënim. Monitorimi duhet kuptuar si një aktivitet i përgjithshëm, i përbërë nga matja e emetimeve, balancimi i masës etj. Ai mund të kryhet në mënyrë të vazhduar ose të ndërprerë.

c) Nëse matjet e emetimeve të NMVOC janë të nevojshme, ato duhet të kryhen në mënyrë të vazhduar, nëse emetimet e NMVOC tejkalojnë 10 kg karbon organik total (TOC)/orë në rrymën e tubit të shkarkimit të një instalimi për reduktimin e emetimeve dhe orët e operimit tejkalojnë 200 orë në vit. Për të gjitha instalimet e tjera, si minimum janë të nevojshme matjet e ndërprera. Për miratimin e pajtueshmërisë, mund të përdoren vetëafrimet, me kusht që ato të jenë po aq rigoroze.

d) Në rastin e matjeve të vazhduara, si kërkesë minimale, pajtueshmëria me standardet e emetimit është arritur nëse mesatarja ditore nuk tejkalon vlerën kufi gjatë punës normale dhe asnjë mesatare për orë nuk i tejkalon vlerat kufi me 150%. Për miratimin e pajtueshmërisë, mund të përdoren vetëafrimet, me kusht që ato të jenë po aq rigoroze.

e) Në rastin e matjeve të ndërprera, si kërkesë minimale, pajtueshmëria me standardet e emetimit është arritur nëse vlera mesatare e të gjitha leximeve nuk e tejkalon vlerën kufi dhe asnjë vlerë mesatare për orë nuk tejkalon vlerat kufi me 150%. Për miratimin e pajtueshmërisë, mund të përdoren vetëafrimet, me kusht që ato të jenë po aq rigoroze.

f) Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar emetime të NMVOC-ve gjatë hapjes dhe mbylljes, si dhe në rastin e devijimeve nga funksionimi normal; dhe

g) Matjet nuk janë të detyrueshme nëse pajisja e reduktimit nuk ka nevojë të pajtohet me vlerat kufi më poshtë dhe mund të demonstron se vlerat kufi nuk janë tejkaluara.

5. Vlerat kufi në vijim duhet të aplikohen për gazrat e mbetura, përveç kur përcaktohet ndryshe:

a) 20 mg substancë/m³ për shkarkimet e komponimeve organike të paqëndrueshme të halogjenizuara (të cilat mbartin frazën e rrezikut: rrezik i mundshëm për ndikime të pakthyeshme), ku rrjedhja në masë e sasisë së komponimeve të shqyrtuara është më e madhe ose e barabartë me 100 g/orë; dhe

b) 2 mg/m³ (e shprehur si shuma e masës së komponimeve individuale) për shkarkimet e komponimeve organike të paqëndrueshme (të cilat mbartin frazën e mëposhtme të rrezikut: mund të shkaktojnë kancer, dëme gjenetike të trashëgueshme, kancer me inhalacion ose dëm të fëmijës së palindur; mund të dëmtojë pjellorinë), ku rrjedhja në masë e sasisë së komponimeve të shqyrtuara është më e madhe ose e barabartë me 10 g/orë.

6. Për kategoritë e burimeve të renditura në paragrafët 9-21 më poshtë, rishikimet e mëposhtme janë të rëndësishme:

a) Në vend të zbatimit të vlerave kufi për instalimet e renditura më poshtë, operatorët e instalimeve përkatëse mund të lejohen të përdorin një skemë reduktimi (shih shtojcën II të këtij aneksi). Qëllimi i një skeme reduktimi është që t'i japë mundësinë operatorit për të arritur me mjete të tjera zvogëlimin e emetimeve të barasvlefshme me ato që do të arrihen, nëse zbatohet vlera kufi e caktuar; dhe

b) Për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC-ve, vlerat e emetimeve të rrjedhjeve të përcaktuara më poshtë do të aplikohen si një vlerë kufi. Megjithatë, kur është demonstruar në mënyrë të pranueshme tek autoriteti kompetent se për një instalim individual kjo vlerë nuk është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur, autoriteti kompetent mund ta përjashtojë këtë instalim, me kusht që të mos priten rreziqe të mëdha për shëndetin e njeriut apo mjedisin. Për çdo derogim, operatori duhet të demonstron në mënyrë të pranueshme për autoritetin kompetent, se është përdorur teknika më e mirë në dispozicion.

7. Vlerat kufi për emetimet VOC për kategoritë e burimeve të përcaktuara në paragrafin 3 do të jenë siç janë përcaktuar në paragrafët 8-21 më poshtë.

8. Ruajtja dhe shpërndarja e benzinës



TABELA 1
VLERAT KUFI PËR EMETIMET VOC TË ÇLIRUARA NGA RUAJTJA DHE SHPËRNDARJA
E BENZINËS, ME PËRJASHTIM TË NGARKIMIT TË ANIJEVE DETARE

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlerat prag	Vlera kufi
Njësia e rikuperimit të avujve që përdoret në objektet e ruajtjes dhe shpërndarjes në serbatorët e rafinerisë në ferma ose terminale	5000 m ³ benzinë xhiro vjetore	10 g VOC/Nm ³ , duke përfshirë metanin

Shënim.

Avujt e zhvendosur nga serbatorët e ruajtjes së benzinës gjatë mbushjes duhet të zhvendosen ose në serbatorë të tjerë ruajtjeje ose në pajisje reduktuese që plotësojnë vlerat kufi në tabelën e mësipërme.

9. Veshja ngjitëse

TABELA 2
VLERAT KUFI PËR EMETIMET NMVOC TË ÇLIRUARA NGA VESHJA NGJITËSE

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)	Vlera kufi	Vlera kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC (% e inputit të tretësve)
Prodhim këpucësh; instalimet e reja dhe ekzistuese	> 5	25 g tretës për palë	
Veshje të tjera ngjitëse, me përjashtim të këpucëve; instalimet e reja dhe ekzistuese	5-15	50 ^{a)} mg C ^{c)} Nm ³	25
	> 15	50 ^{a)} mg C/Nm ³	20

^{a)} Nëse janë përdorur teknika të cilat lejojnë ripërdorimin e tretësit të rikuperuar, vlera kufi do të jetë 150 mg C/Nm³.

10. Laminimi i drurit dhe plastikës

TABELA 3
VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NMVOC TË ÇLIRUARA NGA LAMINIMI I DRURIT
DHE PLASTIKES

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)	Vlera kufi për emetimet totale të NMVOC
Laminimi i drurit dhe plastikës; instalimet e reja dhe ekzistuese	> 5	30 g NMVOC/m ²

11. Proceset e veshjes (sipërfaqe metalike dhe plastike në makinat e pasagjerëve, kabina kamioni, kamionë, autobusë, sipërfaqe prej druri)

TABELA 4
VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NMVOC TË ÇLIRUARA NGA PROCESET E VESHJES NË
INDUSTRINË E MAKINAVE

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)^{a)}	Vlera kufi^{b)} për emetimet totale të NMVOC
Instalime të reja; veshje për makinë (M1, M2)	> 15 (dhe > 5,000 artikuj të veshur në vit)	45 g NMVOC/m ² ose 1,3 kg/artikull dhe 33 g NMVOC/m ²
Instalimet ekzistuese, veshje për makinë (M1, M2)	> 15 (dhe > 5,000 artikuj të veshur në vit)	60 NMVOC g/m ² ose 1,9 kg/artikull dhe 41 g NMVOC/m ²
Instalimet të reja dhe ekzistuese, veshje për makinë (M1, M2)	> 15 (5000 karkasa makine të veshura ose > 3,500 shasi të veshura në vit)	90 g NMVOC/m ² ose 1,5 kg/artikull dhe 70 g NMVOC/m ²
Instalime të reja, veshje kabinë për kamion të ri (N1, N2, N3)	> 15 (5,000 artikuj të veshur në vit)	65 g NMVOC/m ²
Instalime të reja, veshje kabinë për kamion të ri (N1, N2, N3)	> 15 (> 5,000 artikuj të veshur në vit)	NMVOC/m ² 55 g
Instalimet ekzistuese, veshje kabinë për kamion të ri (N1, N2, N3)	> 15 (5,000 artikuj të veshur në vit)	85 g NMVOC/m ²
Instalimet ekzistuese, veshje kabinë për kamion të ri (N1, N2, N3)	> 15 (> 5,000 artikuj të veshur në vit)	75 g NMVOC/m ²
Instalime të reja, veshje për kamion të ri dhe furgonë (pa kabinë) (N1, N2, N3)	> 15 (2,500 artikuj të veshur në vit)	90 g NMVOC/m ²
Instalime të reja, veshje për kamion të ri dhe furgonë (pa kabinë) (N1, N2, N3)	> 15 (> 2,500 artikuj të veshur në vit)	70 g NMVOC/m ²
Instalimet ekzistuese, veshje kamion i ri dhe furgonë (pa kabinë) (N1, N2, N3)	> 15 (2,500 artikuj të veshur në vit)	120 g NMVOC/m ²
Instalimet ekzistuese, veshje kamion i ri dhe furgonë (pa kabinë) (N1, N2, N3)	> 15 (> 2,500 artikuj të veshur në vit)	90 g NMVOC/m ²
Instalime të reja, veshje e autobusëve të rinj (M3)	> 15 (2,000 artikuj të veshur në vit)	210 g NMVOC/m ²
Instalime të reja, veshje e autobusëve të rinj (M3)	> 15 (>2,000 artikuj të veshur në vit)	150 g NMVOC/m ²
Instalimet ekzistuese, veshje e autobusëve të rinj (M3)	> 15 (2,000 artikuj të veshur në vit)	290 g NMVOC/m ²
Instalimet ekzistuese, veshje e autobusëve të rinj (M3)	> 15 (> 2,000 artikuj të veshur në vit)	225 g NMVOC/m ²

^{a)} Për një konsum tretësi 15 Mg në vit (veshja e makinave), zbatohet tabela 14 për rafinimin e makinave.



^{b)} Vlerat e përgjithshme kufi janë të shprehura në lidhje me masën në (g) tretës i emetuar në lidhje me sipërfaqen e produktit (m²). Sipërfaqja e produktit është përcaktuar si sipërfaqe e llogaritur nga zona e përgjithshme e veshjes elektroforetike dhe sipërfaqja e çdo pjesë që mund të shtohet në faza të njëpasnjëshme të procesit të veshjes, të cilat janë mbuluar me të njëjtën veshje.

Sipërfaqja e zonës elektroforetike të veshjes llogaritet duke përdorur formulën: (2x pesha totale e veshjes së produktit): (trashësia mesatare e fletës metalike x dendësia e fletës metalike).

TABELA 5

VLERAT KUFË PËR EMETIMET E NMVOC, TË ÇLIRUARA NGA PROCESËT E VESHJES
NË SEKTORË TË NDRYSHËM INDUSTRIALË

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)	Vlera kufi	Vlera kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC (% e inpueteve të tretësve)
Instalimet e reja dhe ekzistuese: Veshje të tjera, përfshirë metalike, plastike, tekstile, pëlhurë, fletë dhe letër (me përjashtim të shtypjes për tekstile, shih printimin)	5-15	100 ^{a) b)} mg C/Nm ³	25 ^{b)}
	> 15	50/75 ^{b) c) d)} mg C/Nm ³	20 ^{b)}
Instalime të reja dhe ekzistuese: veshje druri	15-25	100 ^{a)} mg C/Nm ³	25
	> 25	50/75 ^{c)} mg C/Nm ³	20

^{a)} Vlera kufi zbatohet për aplikimet e veshjeve dhe proceset e tharjes që operohen në kushtet e përcaktuara.

^{b)} Nëse kushtet e përcaktuara të veshjeve nuk janë të mundura (ndërtimi i anijeve, veshjet e avionëve etj.), instalimet mund të përjashtohen nga këto vlera. Më pas do të përdoret skema e reduktimit e paragrafit 6 (a), përveç rasteve kur është demonstruar, në mënyrë të pranueshme për autoritetin kompetent, se ky opsion nuk është teknikisht dhe ekonomikisht i mundur. Në këtë rast, operatori duhet të demonstrojë, në mënyrë të pranueshme për autoritetin kompetent, se është përdorur teknika më e mirë në dispozicion.

^{c)} Vlera e parë zbatohet për proceset e tharjes, e dyta për proceset e aplikimit të veshjes.

^{d)} Nëse, për veshje tekstili, teknikat që janë përdorur lejojnë ripërdorimin e tretësit të rikuperuar, vlera kufi do të jetë 150 mg C/Nm³ për tharjen dhe veshjen së bashku.

12. Veshje spirale

TABELA 6
VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NMVOC TË ÇLIRUARA NGA VESHJA SPIRALE

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)	Vlera kufi (mg C/Nm ³)	Vlera kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC (% e inputeve të tretësve)
Instalime të reja	> 25	50 ^{a)}	5
Instalime ekzistuese	> 25	50 ^{a)}	10

^{a)} Nëse janë përdorur teknika të cilat lejojnë ripërdorimin e tretësit të rikuperuar, vlera kufi do të jetë 150 mg C/Nm³.

13. Pastrimi kimik

TABELA 7
VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NMVOC TË ÇLIRUARA NGA PASTRIMI KIMIK

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)	Vlera kufi
Instalimet e reja dhe ekzistuese	0	20 g NMVOC/kg ^{a)}

^{a)} Vlera kufi për emetimet totale të NMVOC llogaritet si masë e tretësit të çliruar për masë të produktit të pastruar dhe të thatë.

14. Prodhime të veshjeve, llaqeve, ngjyrave (bojërave) dhe ngjitësve

TABELA 8
VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NMVOC TË ÇLIRUARA NGA PRODHIMI I VESHJEVE, LLAQEVE, NGJYRAVE DHE NGJITËSVE

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)	Vlera kufi (Mg C/Nm ³)	Vlera kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC (% e inputeve të tretësve)
Instalime të reja dhe ekzistuese	100 – 1,000	150 ^{a)}	5 ^{a) c)}
	> 1,000	150 ^{b)}	3 ^{b) c)}

^{a)} Mund të aplikohet një vlerë kufi totale prej 5% të inputit të tretësve në vend të përdorimit të përqendrimit kufi të gazit të mbetur dhe vlerës kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC.

^{b)} Mund të aplikohet një vlerë kufi totale prej 3% të inputit të tretësve në vend të përdorimit të përqendrimit kufi të gazit të mbetur dhe vlerës kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC.

^{c)} Vlera kufi e rrjedhjeve nuk përfshin tretësit e shitur si pjesë e një preparati në një kontejner të mbyllur.



15. Printimi (fleksografi, ngjyrosja e materialeve në të nxehte, botime rotogravurë etj.)

TABELA 9

VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NMVOC TË ÇLIRUARA NGA PROCESET E SHTYPJES
(PRINTIMIT)

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)	Vlera kufi (mgC/Nm ³)	Vlera kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC (% e tretësve në hyrje)
Instalime të reja dhe ekzistuese:	15-25	100	30 ^{a)}
Ngjyrosja e materialeve në të nxehtë	> 25	20	30 ^{a)}
Instalime të reja: Rotogravure publikimi	> 25	75	10
Instalimet ekzistuese: Rotogravurë publikimi	> 25	75	15
Instalime të reja dhe ekzistuese:	15-25	100	25
Rotogravura të tjera, fleksografi, shtypje me ekran rrotullues, njësitë e laminimit dhe lustrimit	> 25	100	20
Instalime të reja dhe ekzistuese: shtypje me ekran rrotullues në tekstile, karton	> 30	100	20

^{a)} Mbetjet e tretësve në produktet e përfunduara nuk duhet të konsiderohen si pjesë e emetimeve të rrjedhjeve të NMVOC-ve.

16. Prodhimi i produkteve farmaceutike

TABELA 10

VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NMVOC TË ÇLIRUARA NGA PRODHIMI I
PRODUKTEVE FARMACEUTIKE

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)	Vlera kufi (Mg C/Nm ³)	Vlerë kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC (% e inputit të tretësve)
Instalime të reja	> 50	20 ^{a) b)}	5 ^{b) d)}
Instalime ekzistuese	> 50	20 ^{a) c)}	15 ^{c) d)}

^{a)} Nëse janë përdorur teknika të cilat lejojnë ripërdorimin e tretësit të rikuperuar, vlera kufi do të jetë 150 mgC/Nm³.

^{b)} Mund të aplikohet një vlerë kufi totale prej 5% të inputit të tretësve në vend të përdorimit të përqendrimit kufi të gazit të mbetur dhe vlerës kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC-së.

^{c)} Mund të aplikohet një vlerë kufi totale prej 15% të inputit të tretësve në vend të përdorimit të përqendrimit kufi të gazit të mbetur dhe vlerës kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC-ve.

^{d)} Vlera kufi e rrjedhjeve nuk përfshin tretësit e shitur si pjesë e një preparati në një kontejner të mbyllur.

17. Konvertimi i gomës natyrale apo sintetike

TABELA 11

VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NMVOC TË ÇLIRUARA NGA KONVERTIMI I GOMËS NATYRALE APO SINTETIKE

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)	Vlera kufi (mgC/Nm ³)	Vlera kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC (% e inputit të tretësve)
Instalimet e reja dhe ekzistuese: Konvertimi i gomës natyrale apo sintetike	> 15	20 ^{a) b)}	25 ^{a) c)}

^{a)} Mund të aplikohet një vlerë kufi totale prej 25% e inputit të tretësve në vend të përdorimit të përqendrimit kufi të gazit të mbetur dhe vlerës kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC-ve.

^{b)} Nëse janë përdorur teknika të cilat lejojnë ripërdorimin e tretësit të rikuperuar, vlera kufi do të jetë 150 mgC/Nm³.

^{c)} Vlera kufi e rrjedhjeve nuk përfshin tretësit e shitur si pjesë e një preparati në një kontejner të mbyllur.

18. Pastrimi i sipërfaqeve

TABELA 12

VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NMVOC TË ÇLIRUARA NGA PASTRIMI I SIPËRFAQEVE

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)	Vlera kufi (mgC/Nm ³)	Vlera kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC-s (% e inputit të tretësve)
Instalime të reja dhe ekzistuese: pastrimi i sipërfaqeve, duke përdorur substancat e përmendura në paragrafin 3 (w)	1-5	20 mg komponim/Nm ³	15
	> 5	20 mg komponim/Nm ³	10
Instalime të reja dhe ekzistuese: pastrimi i sipërfaqeve të tjera	2-10	75 mg C/Nm ^{3 a)}	20 ^{a)}
	> 10 mg	75 C/Nm ^{3 a)}	15 ^{a)}

^{a)} Instalimet të cilat i demonstrojnë autoritetit kompetent se mesatarja e përmbajtjes së tretësit organik për të gjitha materialet e përdorura të pastrimit nuk kalon 30% w/w, janë përjashtuar nga zbatimi i këtyre vlerave.



19. Ekstraktimi i vajit dhe yndyrave shtazore dhe proceset e rafinimit të vajit vegjetal

TABELA 13

VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NMVOC TË ÇLIRUARA NGA EKSTRAKTIMI I YNDYRAVE BIMORE DHE SHTAZORE DHE RAFINIMIT TË VAJIT VEGJETAL

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)	Vlera kufi totale (kg/Mg)
Instalime të reja dhe ekzistuese	> 10	Yndyrë shtazore: 1,5 Kastor: 3.0 Fara berzie: 1.0 Fara luledielli: 1.0 Fasule soje (copëtim normal): 0.8 Fasule soje (e bardhë): 1.2 Fara të tjera dhe materiale bimore: 3.0 ^{a)} Të gjitha proceset e fraksionimit, me përjashtim të degomimit ^{b)} : 1.5 Degomimi: 4.0

^{a)} Vlerat kufi për emetimet totale të NMVOC nga instalimet që trajtojnë vetëm një lloj fare apo materiali tjetër bimor do të përcaktohen rast pas rasti nga autoritetet kompetente në bazë të teknologjive më të mira në dispozicion.

^{b)} Heqja e gomës nga vaji.

20. Refinimi i automjeteve

TABELA 14

VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NMVOC TË ÇLIRUARA NGA REFINIMI I AUTOMJETEVE

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)	Vlera kufi (mgC/Nm ³)	Vlera kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC-s (% e inputit të tretësve)
Instalime të reja dhe ekzistuese	> 0,5	50 ^{a)}	25

^{a)} Pajtueshmëria me vlerat kufitare do të provohet me matje mesatare për 15 minuta.

21. Mbushja e sipërfaqeve prej druri

TABELA 15

VLERAT KUFI PËR EMETIMET E NMVOC TË ÇLIRUARA NGA MBUSHJA E SIPËRFAQEVE PREJ DRURI

Kapaciteti, teknika, specifikime të tjera	Vlera e pragut për konsumin e tretësve (Mg/vit)	Vlera kufi (mgC/Nm ³)	Vlera kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC (% e inputit të tretësve)
Instalime të reja dhe ekzistuese	> 25	100 a/ ^{b)}	45 ^{b)}

a) Nuk zbatohet për mbushjen me katran.

b) Mund të aplikohet një vlerë kufi totale prej 11 kg tretës/m³ dru i trajtuar në vend të përdorimit të përqendrimit kufi të gazit të mbetur dhe vlerës kufi për emetimet e rrjedhjeve të NMVOC.

B. Kanadaja

22. Vlerat kufi për kontrollin e emetimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme (VOC) nga burimet e reja të palëvizshme në kategoritë e mëposhtme të burimit të palëvizshëm do të përcaktohen në bazë të informacionit në dispozicion për kontrollin e teknologjisë dhe niveleve, duke përfshirë vlerat kufi të aplikuara në vendet e tjera dhe dokumentet në vijim:

a) Këshilli i Ministrave Kanadez të Mjedisit (CCME). Kodi i mjedisit i praktikave për reduktimin e emetimeve të tretësve nga qendrat e pastrimit kimik. Dhjetor 1992. PN1053;

b) CCME. Udhëzim i mjedisit për kontrollin e proceseve të emetimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme nga operimet e kimikateve të reja organike. Shtator 1993. PN1108;

c) CCME. Kodi i mjedisit për praktikën në matjen dhe kontrollin e emetimeve të rrjedhjeve të VOC nga rrjedhjet në pajisje. Tetor 1993. PN1106;

d) CCME. Një program për zvogëlimin e emetimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme me 40 për qind nga adezivët dhe ngjitësit. Mars 1994. PN1116;

e) CCME. Një plan për zvogëlimin e emetimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme me 20 për qind nga veshjet e sipërfaqeve të konsumit. Mars 1994. PN1114;

f) CCME. Udhëzime mjedisore për kontrollin e emetimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme nga serbatorët tokësorë të ruajtjes. Qershor 1995. PN1180;

g) CCME. Kodi i mjedisit për praktikën e recuperimit të avujve gjatë furnizimit të automjeteve në pikat e furnizimit dhe në qendra të tjera të shpërndarjes së lëndës djegëse (faza II). Prill 1995. PN1184;

h) CCME. Kodi i mjedisit për praktikën e reduktimit të emetimeve të tretësve nga qendrat tregtare dhe industriale të sgrasatimit. Qershor 1995. PN1182;

i) CCME. Standardet dhe udhëzuesit e burimeve të reja të performancës për reduktimin e emetimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme nga qendrat e veshjes të prodhuesve kanadezë të pajisjeve automobilistike origjinale (OEM). Gusht 1995. PN1234;

j) CCME. Udhëzues i mjedisit për reduktimin e emetimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme nga industria e përpunimit të plastikës. Korrik 1997. PN1276; dhe

k) CCME. Standardet kombëtare për përmbajtjen e komponimeve organike të paqëndrueshme të Kanadasë në produktet e veshjes sipërfaqësore tregtare/industriale – refinimet e automobivele. Gusht 1997. PN1288.

C. Shtetet e Bashkuara të Amerikës

23. Vlerat kufi për kontrollin e emetimeve të VOC nga burimet e reja të palëvizshme në kategoritë e burimeve të palëvizshme janë përcaktuar në dokumentet në vijim:

a) Enët e ruajtjes për lëngjet e benzinës - Kodi 40 i rregullores federale (CFR) pjesa 60, nënpjesa K, dhe nënpjesa Ka;

b) Enët e ruajtjes për lëngjet organike të paqëndrueshme - CFR 40, pjesa 60, nënpjesa Kb;

c) Rafineritë e naftës- CFR 40, pjesa 60, nënpjesa J;

d) Veshje sipërfaqësore të mobiljeve metalike - CFR 40, pjesa 60, nënpjesa EE;

e) Veshje sipërfaqësore për automobila dhe kamionë të lehtë - CFR 40, pjesa 60, nënpjesa MM;

f) Printimi i botimeve të rotogravurave - CFR 40, pjesa 60, nënpjesa QQ;

g) Operimet me shiritat me ndjeshmëri ndaj presionit dhe veshjet me etiketë sipërfaqësore - CFR 40, pjesa 60, nënpjesa RR;



- h) Aplikimet e mëdha, veshjet sipërfaqësore të spiraleve metalike dhe veshjet e konservave të pijeve - CFR 40, pjesa 60, nënpjesa SS, nënpjesa TT dhe nënpjesa WW;
- i) Termialet e gazolinës në masë- CFR 40, pjesa 60, nënpjesa XX;
- j) Prodhimi industrial i rrotave prej gome-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa BBB;
- k) Prodhim industrial i polimereve-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa DDD;
- l) Vinili fleksibël dhe veshje uretani dhe printime-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa FFF;
- m) Rrjedhjet në pajisjet e rafinerisë së naftës dhe sistemet e ujërave të ndotura - CFR 40, pjesa 60, nënpjesa GGG dhe nënpjesa QQQ;
- n) Prodhimi i fibrave sintetike-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa HHH;
- o) Pastruesit kimikë të benzinës-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa JJJ;
- p) Impiantet tokësore të përpunimit të gazit natyror-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa KKK;
- q) Rrjedhjet në pajisjet SOCMi, njësitë e oksidimit të ajrit, operimet e distilimit dhe proceset e reaktorëve - CFR 40, pjesa 60, nënpjesa VV, nënpjesa III, nënpjesa NNN dhe nënpjesa RRR;
- r) Veshjet e shiritave magnetikë-40 CFR pjesa 60, nënpjesa SSS;
- s) Veshjet industriale sipërfaqësore-40 CFR pjesa 60, nënpjesa TTT; dhe
- t) Veshjet me polimere të pajisjeve mbështetëse të substrateve-CFR 40, pjesa 60, nënpjesa VVV.

SHTOJCA I PLANI MENAXHUES I TRETËSVE

Hyrje

1. Kjo shtojcë e aneksit mbi vlerat kufi për emetimet e komponimeve organike të paqëndrueshme jometan (NMVOC) nga burimet e palëvizshme siguron udhëzime për kryerjen e një plani menaxhues për tretësit. Ajo identifikon parimet që do të zbatohen (paragrafi 2), siguron një strukturë për bilancin e masës (paragrafi 3) dhe siguron treguesit për verifikimin e kërkesave të përputhshmërisë (paragrafi 4).

Parimet

2. Plani i menaxhimit të tretësve shërben për qëllimet e mëposhtme:

- a) Verifikimi i pajtueshmërisë, siç përcaktohet në aneks; dhe
- b) Identifikimi i opsioneve të reduktimit në të ardhmen.

Përkufizimet

3. Përkufizimet në vijim ofrojnë një strukturë për ushtrimin e bilancit të masës:

a) Inputet e tretësve organikë:

11. Sasia e tretësit organik ose sasia e tyre në preparatet e gatshme të cilat janë përdorur si inpute në proces në kuadrin kohor gjatë të cilit është llogaritur bilanci i masës.

12. Sasia e tretësit organik ose sasia e tyre në preparatet e rikuperuara dhe të ripërdorura si inpute në proces. (Tretësi i ricikluar llogaritet sa herë që ai përdoret për të kryer aktivitetin.)

b) Prodhimet e tretësve organikë

O1. Emetimet e NMVOC në gazrat e mbetura.

O2. Tretësit organikë të humbur në ujë, nëse është e përshtatshme, duke marrë në konsideratë trajtimin e ujërave të mbetjeve kur llogaritet O5.

O3. Sasia e tretësve organikë që mbeten si ndotës ose mbetje në prodhimin e produkteve nga procesi.

O4. Emetimet e pakapura të tretësve organikë në ajër. Kjo përfshin ventilimin e përgjithshëm të dhomave, ku ajri lëshohet në mjedisin e jashtëm nëpërmjet dritareve, dyerve, daljeve dhe daljeve të ngjashme.

O5. Tretësit organikë dhe/ose komponimet organike që humbin për shkak të reaksioneve kimike ose fizike (duke përfshirë, për shembull, ato që janë shkatërruar, p.sh. me djegie ose trajtime të tjera të gazit të mbetur ose ujërave të mbetura, ose të kapur p.sh. me thithje, për aq kohë sa ato nuk janë përfshirë në O6, O7 ose O8).

O6. Tretësit organikë që ndodhen në mbetjet e grumbulluara.

O7. Tretësit organikë ose tretësit organikë që ndodhen në preparatet, të cilët janë shitur ose janë destinuar për shitje si produkte tregtare të vlefshme.

O8. Tretësit organikë që ndodhen në preparatet e rikuperuara për ripërdorim por jo si inpute në proces, për aq kohë sa ato nuk janë përfshirë në O7.

O9. Tretësit organikë të çliruar në mënyra të tjera.

Udhëzime për përdorimin e planit të menaxhimit të tretësve për verifikimin e përputhshmërisë

4. Përdorimi i planit të menaxhimit të tretësve do të përcaktohet nga kërkesa e veçantë e cila do të verifikohet, si vijon:

a) Verifikimi i pajtueshmërisë me opsionin për reduktimin e përmendur në paragrafin 6 (a) të aneksit, me vlerën kufi totale të shprehur në emetimet e tretësit për njësi të produktit, ose siç shprehet ndryshe në aneks.

i) Për të gjitha aktivitetet që përdorin opsionin e reduktimit të përmendur në paragrafin 6 (a) të aneksit, plani i menaxhimit të tretësve do të vihet në zbatim çdo vit për të përcaktuar konsumin. Konsumi mund të llogaritet me anë të ekuacionit të mëposhtëm:

$$C = I1 - O8$$

Një ushtrim paralel duhet të ndërmerret për të përcaktuar lëndët e ngurta të përdorura në veshjet në shtresë, në mënyrë që të përftohet emetimi vjetor referues dhe emetimi i synuar për çdo vit;

ii) Për vlerësimin e pajtueshmërisë me vlerën kufi totale të shprehur në emetimet e tretësit për njësi produkti ose siç shprehet ndryshe në aneks, plani i menaxhimit të tretësve do të zbatohet çdo vit për të përcaktuar emetimet e NMVOC. Emetimet e NMVOC mund të llogariten me anë të ekuacionit të mëposhtëm:

$$E = F + O1$$

Ku F është emetimi i rrjedhjeve të NMVOC, siç përcaktohet në nënparagrafin (b) (i) më poshtë. Shifra e emetimit do të ndahet sipas parametrut përkatës të produktit;

b) Përcaktimi i emetimit të rrjedhjeve të NMVOC për ta krahasuar me vlerat e emetimit të rrjedhjeve në aneks:

i) Metodologjia: Emetimet e rrjedhjeve të NMVOC mund të llogariten me anë të ekuacionit të mëposhtëm:

$$F = I1 - O1 - O5 - O6 - O7 - O8$$

ose

$$F = O2 + O3 + O4 + O9$$

Kjo sasi mund të përcaktohet me matje direkte të sasive. Si alternativë, mund të kryhen llogaritje të barasvlefshme me mënyra të tjera, për shembull duke përdorur efikasitetin e sistemit të kapjes të procesit.

Vlera e emetimit të rrjedhjeve është shprehur si përqindje e inputit, e cila mund të llogaritet me anë të ekuacionit të mëposhtëm:

$$I = I1 + I2$$

ii) Frekuenca: Emetimet e rrjedhjeve të NMVOC-s mund të përcaktohen nga një seri e shkurtër por e plotë matjesh. Kjo nuk është e nevojshme të rikryhet deri në modifikimin e pajisjes.



SHTOJCA II SKEMA E REDUKTIMIT

Parimet

1. Qëllimi i skemës së reduktimit është që t'i lejojë operatorit mundësinë për të arritur me metoda të tjera zvogëlimin e emetimit në vlera ekuivalente me ato që do të arrihen nëse aplikohen vlerat kufi. Për këtë qëllim operatori mund të përdorë çdo skemë reduktimi të projektuar veçanërisht për instalimin e tij, me kusht që të arrihet një reduktim ekuivalent i emetimit. Palët duhet të raportojnë për progresin në arritjen e të njëjtit reduktim të emetimit, duke përfshirë edhe përvojën në lidhje me zbatimin e skemës së reduktimit.

Praktika

2. Nëse aplikohen veshje, llaqe, adezivë ose ngjyra, mund të përdoret skema e mëposhtme. Kur kjo është e papërshtatshme, autoriteti kompetent mund të lejojë një operator të aplikojë ndonjë skemë tjetër alternative, e cila plotëson në mënyrë të kënaqshme parimet e përshkruara këtu. Projekti i skemës merr në konsideratë faktet e mëposhtme:

a) Kur zëvendësuesit që përmbajnë pak ose aspak tretës janë ende në fazën e zhvillimit, operatorit duhet t'i jepet një zgjatje kohore për zbatimin e planeve të tij të reduktimit të emetimit;

b) Pika e referimit për zvogëlimin e emetimit duhet të korrespondojë sa më afër të jetë e mundur me emetimet që do të kishin rezultuar pa pasur asnjë veprim zvogëlimi.

3. Skema në vijim do të operojë për instalimet për të cilat përmbajtja e ngurtë e produktit mund të supozohet konstante dhe mund të përdoret për të përcaktuar pikën e referimit për zvogëlimin e emetimit:

a) Operatori do të parashikojë një plan për reduktimin e emetimit i cili përfshin në mënyrë të veçantë zvogëlimin e përmbajtjes mesatare totale të tretësit në input dhe/ose rritjen e efikasitetit të përdorimit të lëndëve të ngurta për të arritur nga instalimi një reduktim total në një përqindje të caktuar të emetimeve referuese vjetore, i quajtur emetimi i synuar. Kjo duhet të bëhet në afatin e mëposhtëm:

Periudha kohore		Maksimumi i lejuar i emetimeve totale vjetore
Instalime të reja	Instalime ekzistuese	
31.10.2001	31.10.2005	Emetimi i synuar x 1,5
31.10.2004	31.10.2007	Emetimi i synuar

b) Emetimi referues vjetor është llogaritur si vijon:

i) Përcaktohet masa totale e materialeve të ngurta në sasinë e veshjes dhe/ose bojës, llakut ose adezivëve të konsumuar në një vit. Materialet e ngurta janë të gjitha materialet në veshje, ngjyra, llaqe dhe ngjitëse që bëhen të ngurtë sapo uji ose komponimet organike të paqëndrueshme të avullohen;

ii) Emetimet vjetore referuese janë llogaritur duke shumëzuar masën e përcaktuar si në nënparagrafin (i) me faktorin e përshtatshëm të renditur në tabelën e mëposhtme. Autoritetet kompetente mund të përshtatin këta faktorë për instalimet individuale për të pasqyruar të dokumentuar efikasitetin e rritur në përdorimin e materialeve të ngurta.

Veprimtaria (aktiviteti)	Faktori i shumëzimit për përdorim në nënparagrafin (b) (ii)
Printimi i rotogravurave, printimi me fleksografi; laminimi si pjesë e një aktiviteti të printimit, printimi, lustrim si pjesë e një aktiviteti të printimit); veshje druri, veshje e tekstileve, pëlhurë, film apo letër, veshje adezive	4
Veshje spirale; refinimi i automjeteve	3
Veshje në kontakt me ushqimin; veshje për pajisje ajrore	2.33
Veshje të tjera dhe printim me ekran rrotullues	1.5

iii) Emetimi i synuar është i barabartë me emetimin vjetor referues shumëzuar me një përqindje të barabartë me:

- (Vlerën e emetimit të rrjedhjes + 15), për instalimet në sektorët e mëposhtëm;
- Veshjen e automjeteve (konsumi i tretësit < 15 Mg / vit) dhe refinimi i automjeteve;
- Veshjen e metalit, plastikës, tekstileve, pëlhurës, filmit dhe letrës (konsumi i tretësit në intervalin 5 dhe 15 Mg/vit);

- Veshje e sipërfaqeve prej druri (konsumi i tretësit në intervalin 15 dhe 25 Mg/vit);

- (Vlera e emetimit të rrjedhjes + 5) për të gjitha instalimet e tjera;

iv) Pajtueshmëria është arritur nëse emetimi aktual i tretësve i përcaktuar në planin e menaxhimit të tretësve është më pak ose i barabartë me emetimin e synuar.

ANEKSI VII AFATET KOHORE SIPAS NENIT 3

1. Afatet kohore për zbatimin e vlerave kufi të përmendura në nenin 3, paragrafët 2 dhe 3, do të jenë:

a) Për burimet e reja të palëvizshme, një vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokollit për palën në fjalë; dhe

b) Për burimet e palëvizshme ekzistuese:

i) Në rast të një pale që nuk është një vend me ekonomi në tranzicion, një vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokollit ose 31 dhjetor 2007, cilado që është më e vona; dhe

ii) Në rast të një pale që është një vend me ekonomi në tranzicion, tetë vjet pas hyrjes në fuqi të këtij protokollit.

2. Afatet kohore për zbatimin e vlerave kufi për lëndët djegëse dhe burimet e reja të lëvizshme të përmendura në nenin 3, paragrafi 5, dhe vlerat kufi për lëndët djegëse të gazta të përmendura në aneksin IV, tabela 2, do të jenë:

i) Në rast të një Pale që nuk është një vend me ekonomi në tranzicion, data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit ose datat e shoqëruara me masat e përcaktuara në aneksin VIII dhe me vlerat kufi të përcaktuara në aneksin IV, tabela 2, cilado që është data më e vonë; dhe

ii) Në rast të një pale që është një vend me ekonomi në tranzicion, pesë vjet pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokollit ose pesë vjet pas datave të shoqëruara me masat e përcaktuara në aneksin VIII dhe me vlerat kufi në aneksin IV, tabela 2, cilado që është më vonë.

Këto afate kohore nuk do të zbatohen për një palë të këtij protokollit, në atë rast kur kjo palë është subjekt i një afati kohor më të shkurtër në lidhje me lëndët djegëse të gazta, në kuadrin e protokollit për pakësimin e mëtejshëm të emetimeve të squfurit.



3. Për qëllim të këtij aneksi, “një vend me ekonomi në tranzicion” do të thotë një palë që me instrumentet e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit ka bërë një deklaratë që ai dëshiron të trajtohet si vend me ekonomi në tranzicion, për qëllime të paragrafëve 1 dhe/ose 2 të këtij aneksi.

ANEKSI VIII VLERAT KUFË PËR LËNDËT DJEGËSE DHE BURIMET E REJA TË LËVIZSHME

Hyrje

1. Seksioni A zbatohet për të gjitha palët përveç Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, seksioni B zbatohet për Kanadanë dhe seksioni C zbatohet për Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

2. Aneksi përmban vlerat kufi për NO_x, të shprehura si vlera ekuivalente të dyoksidit të azotit (NO₂), dhe për hidrokarburet, shumica e të cilave janë komponime organike të paqëndrueshme, si dhe specifikimet mjedisore për lëndët djegëse që tregtohen për automjetet.

3. Afatet kohore për zbatimin e vlerave kufi të këtij aneksi janë dhënë në aneksin VII.

A. Palët përveç Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Makinat e pasagjerëve dhe automjetet e lehta

4. Vlerat kufi për automjetet me fuqi drejtuese me të paktën katër rrota dhe që përdoren për transportin e udhëtarëve (kategoria M) dhe mallrave (kategoria N) janë dhënë në tabelën 1.

Automjetet e rënda

5. Vlerat kufi për motorët e automjeteve të rënda janë dhënë në tabelat 2 dhe 3, në varësi të procedurave të zbatuara për testimet.

Motoçikleta dhe motoçikleta të vogla

6. Vlerat kufi për motoçikleta dhe motoçikleta të vogla janë dhënë në tabelën 6 dhe në tabelën 7.

Automjetet dhe makinat jorrugore

7. Vlerat kufi për traktorët bujqësorë dhe pyjorë dhe për motorët e automjeteve/makinave të tjera jo rrugore janë renditur në tabelat 4 dhe 5. Faza I (tabela 4) bazohet në rregulloren ECE 96, “Dispozita uniforme në lidhje me miratimin e motorëve me ndezje me kompresim - (CI) që duhet të instalohen në traktorë bujqësorë dhe pyjorë në lidhje me emetimet e ndotësve nga motorët”.

Cilësia e lëndës djegëse

8. Specifikimet mjedisore të cilësisë për benzinën dhe dizelin janë dhënë në tabelat 8-11.

TABELA 1
VLERAT KUFI PËR MAKINAT E PASAGJERËVE DHE AUTOMJETET E LEHTA

				Masa referuese (RW) (Kg)	Vlerat kufi								
					Monoksid karboni		Hidrokarbure		Oksidet e azotit		Hidrokarburet dhe oksidet e azotit të kombinuar		Grimcat ^{a)}
					L1 (g/km)		L2 (g/km)		L3 (g/km)		L2 + L3 (g/km)		L4(g/km)
Kategoria	Klasa	Për t'u zbatuar nga ^{b)}			Benzinë	Dizel	Benzinë	Dizel	Benzinë	Dizel	Benzinë	Dizel	Dizel
A	M ^{c)}		1.1.2001	E gjitha ^{a)}	2.3	0.64	0.20	-	0.15	0.50	-	0.56	0.05
	N1 ^{d)}	I	1.1.2001 ^{e)}	RW 1305	2.3	0.64	0.20	-	0.15	0.50	-	0.56	0.05
		II	1.1.2002	1305 < RW 1760	4.17	0.80	0.25	-	0.18	0.65	-	0.72	0.07
		III	1.1.2002	1760 < RW	5.22	0.95	0.29	-	0.21	0.78	-	0.86	0.10
B	M ^{c)}		1.1.2006	gjitha	1.0	0.50	0.10	-	0.08	0.25	-	0.30	0.025
	N1 ^{d)}	I	1.1.2006 ^{f)}	RW 1305	1.0	0.50	0.10	-	0.08	0.25	-	0.30	0.025
		II	1.1.2007	1305 < RW 1760	1.81	0.63	0.13	-	0.10	0.33	-	0.39	0.04
		III	1.1.2007	1760 < RW	2.27	0.74	0.16	-	0.11	0.39	-	0.46	0.06

^{a)} Për motorët me ndezje me kompresion.

^{b)} Regjistrimi, shitja ose hyrja në shërbim e automjeteve të reja që nuk janë në përputhje me vlerat përkatëse kufi do të refuzohen që nga datat e dhëna në këtë kolonë dhe miratimi nuk mund të jepet 12 muaj para këtyre datave.

^{c)} Përveç automjeteve masa maksimale e të cilëve i tejkalon 2,500 kg.

^{d)} Dhe automjetet e kategorisë M të përcaktuara në shënimin c.

^{e)} 1.1.2002 për automjetet e kategorisë M të përcaktuara në shënimin c.

^{f)} 1.1.2007 për automjetet e kategorisë M të përcaktuara në shënimin c.

^{g)} Deri më 1 janar 2003, automjetet në këtë kategori që përputhen me motorët me ndezje me kompresion e që janë automjete jorrugore dhe automjete me një masë maksimale prej më shumë se 2,000 kg, të cilët janë projektuar për të mbartur më shumë se gjashtë pasagjerë, duke përfshirë edhe shoferin, do të konsiderohen si automjete në kategorinë N1, klasa III, radha A.

TABELA 2
VLERAT KUFI PËR AUTOMJETET E RËNDA – TESTET CIKLI EUROPIAN NË GJENDJE TË QËNDRUESHME (ESC) DHE TESTET EUROPIANE PËR REAGIMIN NDAJ NGARKESAVE – (ELR)

Radha	Për t'u zbatuar nga ^{a)}	Monoksid karboni (g/kWh)	Hidrokarbure (g/kWh)	Oksidet e azotit (g/kWh)	Grimcat (g/kWh)	Tymi (m-1)
A	1.10.2001	2.1	0.66	5.0	0.10/0.13 ^{b)}	0,8
B1	1.10.2006	1.5	0.46	3.5	0.02	0,5
B2	1.10.2009	1.5	0.46	2.0	0.02	0,5

^{a)} Duke filluar nga afatet e dhëna dhe me përjashtim të automjeteve dhe motorëve të destinuar për eksport në vendet që nuk janë palë në këtë protokoll dhe për zëvendësimin e motorëve



për automjetet në përdorim, palët do të ndalojnë regjistrimin, shitjen, hyrjen në shërbim ose përdorimin e automjeteve të reja që vihen në lëvizje nga një motor me ndezje me kompresion ose motor me gaz dhe shitjen dhe përdorimin e motorëve të rinj me ndezje me kompresion apo me gaz, nëse emetimet e tyre nuk përputhen me vlerat kufi përkatëse. Duke filluar dymbëdhjetë muaj para këtyre datave, miratimi mund të refuzohet nëse vlerat kufi nuk janë në përputhje me të.

^{b)} Për motorët me një vëllim nën 0.75 dm^3 për cilindër dhe një shpejtësi nominale fuqie mbi 3000 rrotullime për minutë.

TABELA 3
VLERAT KUFI PËR AUTOMJETET E RËNDA - TESTI EUROPIAN I CIKLIT KALIMTAR
(ETC) ^{a)}

Stadi	Për t'u aplikuar nga ^{b)}	Monoksid karboni (g/kWh)	Hidrokarbure jo metan (g/kWh)	Metan ^{c)} (g/kWh)	Oksidet e Azotit (g/kWh)	Grimcat ^{d)}
A (2000)	1.10.2001	5.45	0.78	1.6	5.0	0.16/0.21 ^{e)}
B1(2005)	1.10.2006	4.0	0.55	1.1	0.03	3.5
B2(2008)	1.10.2009	4.0	0.55	1.1	0.03	2.0

^{a)} Kushtet për verifikimin e pranueshmërisë së testeve ETC kur maten shkarkimet e motorëve me gaz kundrejt vlerave kufi të zbatueshme në radhën A, do të rishqyrtohen, dhe kur është e nevojshme, do të modifikohen në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 13 të direktivës 70/156/EEC.

^{b)} Duke filluar nga afatet e dhëna dhe me përjashtim të automjeteve dhe motorëve të destinuar për eksport në vendet që nuk janë palë në këtë protokoll dhe për zëvendësimin e motorëve për automjetet në përdorim, palët do të ndalojnë regjistrimin, shitjen, hyrjen në shërbim ose përdorimin e automjeteve të reja që vihen në lëvizje nga një motor me ndezje me kompresion apo me gaz dhe shitjen dhe përdorimin e motorëve të rinj me ndezje me kompresion apo me gaz, nëse emetimet e tyre nuk përputhen me vlerat kufi përkatëse. Duke filluar dymbëdhjetë muaj para këtyre datave, miratimi mund të refuzohet nëse vlerat kufi nuk janë në përputhje me të.

^{c)} Vetëm për motorët me gaz natyror.

^{d)} Nuk aplikohet për motorët me gaz në stadin A dhe stadin B1 dhe B2.

^{e)} Për motorët me një vëllim nën 0.75 dm^3 për cilindër dhe një shpejtësi nominale mbi 3000 rrotullime për minutë.

TABELA 4
VLERAT KUFI (STADI I) PËR MOTORËT DIZEL PËR MAKINA JORRUGORE TË LËVIZSHME (PROCEDURE MATJEJE ISO 8178)

Fuqia neto (P) (KW)	Për t'u aplikuar nga ^{a)}	Monoksid karboni (g/kWh)	Hidrokarbure (g/kWh)	Oksidet e Azotit (g/kWh)	Lënda e gtimcuar (g/kWh)
130 P < 560	31.12.1998	5.0	1.3	9.2	0.54
75 P < 130	31.12.1998	5.0	1.3	9.2	0.70
37 P < 75	31.03.1998	6.5	1.3	9.2	0.85

^{a)} Duke filluar nga data e caktuar dhe me përjashtim të makinerive dhe motorëve të destinuar për eksport në vende që nuk janë palë në këtë protokoll, palët do të lejojnë regjistrimin, kur është e zbatueshme, si dhe daljen në treg të motorëve të rinj, të instaluar ose jo në makineri, vetëm në rast

se ato plotësojnë vlerat kufi të përcaktuara në tabelë. Miratimi për një tip ose familje motori do të refuzohet nëse ai nuk i plotëson vlerat kufi, duke filluar nga data 30 qershor 1998.

Shënim.

Këto kufij janë kufijtë jashtë motorit dhe do të arrihen përpara shërbimit të shkarkimit pas trajtimit.

TABELA 5
VLERAT KUFI (STADI II) PËR MOTORËT DIZEL PËR MAKINA JO- RRUGORE TË LËVIZSHME (PROCEDURA E MATJES ISO 8178)

Fuqia neto (P) (KW)	Për t'u aplikuar nga^{a)}	Monoksid karboni (g/kWh)	Hidrokarbure (g/kWh)	Oksidet e azotit (g/kWh)	Lënda e grimcuar (g/kWh)
130 P < 560	31.12.2001	3.5	1.0	6.0	0.2
75 P < 130	31.12. 2002	5.0	1.0	6.0	0.3
37 P < 75	31.12. 2003	5.0	1.3	7.0	0.4
18 P < 37	31.12. 2000	5.5	1.5	8.0	0.8

^{a)} Duke filluar nga data e dhënë dhe me përjashtim të makinerive dhe motorëve të destinuar për eksport në vende që nuk janë palë në këtë protokoll, palët do të lejojnë regjistrimin, kur është e zbatueshme, si dhe daljen në treg të motorëve të rinj, të instaluar ose jo në makineri, vetëm nëse ata plotësojnë vlerat kufi të përcaktuara në tabelë. Miratimi për një tip ose familje motori do të refuzohet nëse ai nuk i plotëson vlerat kufi, duke filluar dymbëdhjetë muaj para këtyre datave.

TABELA 6
VLERAT KUFI PËR MOTOÇIKLETA DHE AUTOMJETE ME 3 - DHE 4 - RROTA (> 50 CM³; > 45 KM/H) QË DO TË APLIKOHEN MË 17 QERSHOR 1999 ^{a)}

Lloji i motorit	Vlerat kufi
2-kohësh	CO = 8 g/km HC = 4 g/km NOx = 0.1 g/km
4-kohësh	CO = 13 g/km HC = 3 g/km NOx = 0.3 g/km

^{a)} Miratimi do të refuzohet duke filluar nga data e dhënë, nëse emetimet e automjeteve nuk i plotësojnë vlerat kufi.

Shënim.

Për 3 - dhe 4 - rrotëshit, vlerat kufi duhet të shumëzohen me 1.5.



TABELA 7
VLERAT KUFË PËR MOTOÇIKLETA TË VOGLA (50 CM³; < 45 KM/ORË)

Stadi	Për tu zbatuar nga ^{a)}	Vlerat kufi	
		CO (g/km)	HC + NOx (g/km)
I	17.6.1999	6.0 ^{b)}	3.0 ^{b)}
II	17.6.2002	1.0 ^{c)}	1.2

^{a)} Miratimi do të refuzohet duke filluar nga data e dhënë, nëse emetimet e automjeteve nuk i plotësojnë vlerat kufi.

^{b)} Për 3 - dhe 4 - rrotëshit, shumëzohet me 2.

^{c)} Për 3 - dhe 4 - rrotëshit, 3.5 g/km.

TABELA 8
SPECIFIKIMET MJEDISORE PËR LËNDËT DJEGËSE QË TREGTOHEN PËR PËRDORIM NË
AUTOMJETET E PAJISURA ME MOTORË ME NDEZJE-POZITIVE

Tipi: benzinë

Parametrat	Njësia	Kufijtë ^{a)}		Testi	
		Minimale	Maksimale	Metoda ^{b)}	Data e botimit
Studimi i numrit të oktanit		95	-	EN 25164	1993
Numri i oktanit të Motorit		85	-	EN 25163	1993
Presioni i avujve në ecje, periudhë verore ^{c)}	kPa	-		EN 60 12	1993
Distilimi:					
Avullimi në 100 ° C	% v/v	46	-	EN-ISO 3405	1988
Avullimi në 150 ° C	% v/v	75	-		
Analiza e Hidrokarbureve					
- Olefinat	% v/v	-	18.0 d/	ASTM D1319	1995
- Aromatikët		-	42	ASTM D1319	1995
- Benzoli		-	1	projekti EN 12177	1995
Përmbajtja e Oksigjenit	% m/m	-	2.7	EN 1601	1996
Oksigjenatet:					
- Metanol, duhet të shtohen agjentët stabilizues	% v/v	-	3	EN 1601	1996
- Etanol, agjentët stabilizues mund të jenë të nevojshëm	% v/v	-	5	EN 1601	1996
- Alkool iso-propil	% v/v	-	10	EN 1601	1996
- Alkool tert-butil	% v/v	-	7	EN 1601	1996
- Alkool iso-butil	% v/v	-	10	EN 1601	1996
- Eteret që përmbajnë 5 ose më shumë atome karboni në molekulë	% v/v	-	15	EN 1601	1996
Oksigjenate të tjerë ^{e)}	% v/v	-	10	EN 1601	1996
Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	150	projekti EN-ISO/Dis 14596	1996

^{a)} Vlerat e cituara në specifikime janë “vlerat e vërteta”. Në përcaktimin e vlerave të tyre kufi, janë aplikuar termat e ISO 4259, “Produktet e Benzinës - Përcaktimi dhe zbatimi i të dhënave të saktësisë në lidhje me metodat e testimit “ dhe, në fiksimin e vlerës më të vogël, është marrë në konsideratë një diferencë minimale 2R mbi zero

(R=riprodhueshmëria). Rezultatet e matjeve individuale do të interpretohen në bazë të kritereve të përshkruara në ISO 4259 (botuar në 1995).

^{b)} EN - standard europian; ASTM - Shoqëria Amerikane për Testimin dhe Materialet; DIS - Draft standard ndërkombëtar.

^{c)} Periudha verore do të fillojë jo më vonë se 1 maji dhe nuk do të përfundojë përpara 30 shtatorit. Për shtetet anëtare me kushte arktike, periudha e verës do të fillojë jo më vonë se 1 qershori dhe nuk do të përfundojë përpara 31 gushtit dhe RVP është kufizuar në 70 kPa.

^{d)} Përveç benzinës së rregullt pa plumb (numri minimal i oktanit motorik (MON) 81 dhe numri minimal i oktanit kërkimor (RON) 91), për të cilën përmbajtja maksimale e olefines do të jetë 21% v/v. Këta kufij nuk përjashtojnë prezantimin në treg të një shteti anëtar me një benzinë tjetër pa plumb me numër oktani më të ulët se atë të përcaktuar këtu.

^{e)} Monoalkoole të tjerë me një pikë fundore distilimi jo më të lartë se pika fundore e distilimit e përcaktuar në specifikimet kombëtare ose, kur këto nuk ekzistojnë, në specifikimet industriale për lëndët djegëse motorike.

Shënim.

Palët do të sigurojnë që, jo më vonë se data 1 janar 2000, benzina mund të tregtohet brenda territorit të tyre vetëm nëse është në pajtim me specifikimet mjedisore të përcaktuara në tabelën 8. Kur një palë përcakton se ndalimi i benzinës me përmbajtje të sulfurit që nuk përputhet me specifikimet e përmbajtjes së squfurit në tabelën 8, por nuk e tejkalon përmbajtjen e tanishme, do të sjellë vështirësi të mëdha për industrinë e saj duke bërë ndryshimet e nevojshme në objektet e tyre prodhuese deri në 1 janar 2000, ajo mund të zgjasë afatin kohor të tregtimit brenda territorit të saj maksimumi deri më 1 janar 2003. Në këtë rast pala do të përcaktojë, në një deklaratë që do të depozitohet së bashku me instrumentet e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, që ajo synon të zgjasë periudhën e kohës dhe do të paraqesë informacion me shkrim në organin ekzekutiv me arsyet në lidhje me këtë.

TABELA 9

SPECIFIKIMET MJEDISORE MBI LËNDËT DJEGËSE PËR TREGTIM QË DO TË PËRDOREN NË AUTOMJETET E PAJISURA ME MOTORË ME NDEZJE ME KOMPRESION

Tipi: lëndë djegëse dizel

Parametrat	Njësia	Kufijtë ^{a)}		Testimi	
		Minimale	Maksimale	Metoda ^{b)}	Data e botimit
Numri i Cetanit		51	-	EN-ISO 5165	1992
Densiteti në 15°C	kg/m ³	-	845	EN-ISO 3675	1995
Pika e distilimit: 95%	° C	-	360	EN-ISO 3405	1988
Hidrokarbure aromatike policiklike	% m/m	-	11	IP 391	1995
Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	350	Projekti EN-ISO/DIS 14596	1996

^{a)} Vlerat e cituara në specifikime janë “vlerat e vërteta”. Në përcaktimin e vlerave të tyre kufi janë aplikuar termat e ISO 4259, “Produktet e naftës - Përcaktimi dhe zbatimi i të dhënave të



saktësisë në lidhje me metodat e testimit”, dhe në caktimin e vlerës më të vogël është marrë në konsideratë një diferencë minimale 2R mbi zero (R= riprodhueshmëria). Rezultatet e matjeve individuale do të interpretohen në bazë të kritereve të përshkruara në ISO 4259 (botuar në 1995).

^{b)} EN - Standard European; IP - Instituti i Naftës, DIS – Draft standarde ndërkombëtare.

Shënim.

Palët do të sigurojnë, jo më vonë se data 1 janar 2000, lënda djegëse dizel mund të tregtohet brenda territorit të tyre vetëm nëse është në pajtim me specifikimet mjedisore të përcaktuara në tabelën 9. Kur një palë konstaton se ndalimi i lëndës djegëse dizel me përmbajtje sulfuri që nuk pajtohet me specifikimet e përmbajtjes së sqfurit në tabelën 9, por nuk e tejkalon përmbajtjen e tanishme, do të krijojë vështirësi të mëdha për industrinë e saj në kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në objektet e tyre prodhuese deri në 1 janar 2000, ai mund të zgjasë periudhën e tregtimit brenda territorit të tij deri maksimumi më 1 janar 2003. Në këtë rast pala do të deklarojë, në një deklaratë që do të depozitohet së bashku me instrumentet e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, që ajo synon të zgjasë periudhën e kohës dhe të paraqesë me shkrim informacion tek organi ekzekutiv me arsyet në lidhje me këtë.

TABELA 10
SPECIFIKIMET MJEDISORE PËR LËNDË DJEGËSE PËR TREGTIM QË DO TË PËRDORET
PËR AUTOMJETET E PAJISURA ME MOTORË ME NDEZJE-POZITIVE

Tipi: benzinë

Parametrat	Njësia	Kufijtë ^{a)}		Testimi	
		Minimale	Maksimale	Metoda ^{b)}	Data e botimit
Studimi i numrit të oktanit		95	-	EN 25164	1993
Numri oktan i motorit		85	-	EN 5163	1993
Presioni i avujve në ecje, periudha verore	kPa	-			
Distilimi:					
avullimi në 100°C	% v/v	-	-		
avullimi në 150°C		-	-		
Analizat e Hidrokarbureve:					
- Olefinat	% v/v	-			
- Aromatikët	% v/v	-	35	ASTM D1319	1995
- Benzol	% v/v	-			
Përmbajtja e Oksigjenit	% m/m	-			
Përmbajtja e sqfurit	mg/kg	-	50	projekti EN-ISO/ DIS 14596	1996

^{a)} Vlerat e cituara në specifikimet janë “vlera të vërteta”. Në përcaktimin e vlerave të tyre limite janë aplikuar termat e ISO 4259, “Produktet e petrolit - Përcaktimi dhe zbatimi i të dhënave të saktësisë në lidhje me metodat e testimit”, dhe në vendosjen e vlerave minimale, është marrë në konsideratë diferenca minimale 2R mbi vlerën zero (R= riprodhueshmëria). Rezultatet e matjeve individuale do të interpretohen në bazë të kritereve të përshkruara në ISO 4259 (botuar në 1995).

^{b)} EN - Standard European; ASTM –Shoqëria amerikane për testimin dhe materialet; DIS – Draft Standard ndërkombëtar.

Shënim.

Palët do të sigurojnë që, jo më vonë se data 1 janar 2005, benzina mund të tregtohet brenda territorit të tyre vetëm nëse është në pajtim me specifikimet mjedisore të përcaktuara në tabelën 10. Kur një palë përcakton se ndalimi i benzinës me përmbajtje squfuri që nuk është në pajtim me specifikimet për përmbajtjen e squfurit në tabelën 10, por pajtohet me tabelën 8, do të krijojë vështirësi të mëdha për industrinë e saj duke bërë ndryshimet e nevojshme në objektet e tyre prodhuese më 1 janar 2005, mund të zgjasë periudhën e kohës se tregtimit brenda territorit të saj maksimumi deri me 1 janar 2007. Në këtë rast pala do të përcaktojë, në një deklaratë që do të depozitohet së bashku me instrumentet e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, që ajo synon të zgjasë periudhën e kohës dhe të paraqesë informacion me shkrim pranë organit ekzekutiv me arsyet në lidhje me këtë.

TABELA 11
SPECIFIKIMET MJEDISORE TË LËNDËS DJEGËSE PËR TREGTIM QË DO TË PËRDORET
PËR AUTOMJETET E PAJISURA ME MOTORË ME NDEZJE ME KOMPRESION

Tipi: lëndë djegëse dizel

Parametrat	Njësia	Kufijtë ^{a)}		Testimi	
		minimale	maksimale	Metoda ^{b)}	Data e botimit
Numri i Cetanit			-		
Densiteti në 15°C	kg/m ³		-		
Pika e distilimit: 95%	° C	-			
Hidrokarbure aromatike policiklike	% m/m	-			
Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	50	projekti EN-ISO/ DIS 14596	1996

^{a)} Vlerat e cituara në specifikime janë “vlerat e vërteta “. Në përcaktimin e vlerave të tyre kufi, janë aplikuar termat e ISO 4259, “Produktet e naftës - Përcaktimi dhe aplikimi i të dhënave të saktësisë në lidhje me metodat e testimit”, dhe në caktimin e një vlere minimale, është marrë në konsideratë një diferencë minimale 2R mbi vlerën zero (R= riprodhueshmëria). Rezultatet e matjeve individuale do të interpretohen në bazë të kritereve të përshkruara në ISO 4259 (botuar në 1995).

^{b)} EN - Standard Evropian; DIS – Draft Standard ndërkombëtar.

Shënim. Palët do të sigurojnë që, jo më vonë se data 1 janar 2005, lënda djegëse dizel mund të tregtohet brenda territorit të tyre vetëm nëse është në pajtim me specifikimet mjedisore të përcaktuara në tabelën 11. Kur një palë përcakton se ndalimi i lëndës djegëse dizel me përmbajtje sulfuri që nuk është në pajtim me specifikimet e përmbajtjes së squfurit në tabelën 11, por pajtohet me tabelën 9, do të krijojë vështirësi të mëdha për industrinë e saj në kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në objektet e tyre prodhuese më 1 janar 2005, ai mund të zgjasë periudhën e tregtimit brenda territorit të tij maksimumi deri me 1 janar 2007. Në këtë rast Pala do të përcaktojë, në një deklaratë, që do të depozitohet së bashku me të instrumentet e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, që ajo synon të zgjasë periudhën e kohës dhe të paraqesë me shkrim informacionin pranë Organit Ekzekutiv me arsyet në lidhje me këtë.

B. Kanadaja

23. Standardet e reja të emetimeve për automjetet e lehta, kamionë të lehtë, automjete të rëndë, motorë të rëndë dhe motoçikleta: Akti i sigurisë për motorët e automjeteve (dhe legjislacioni



pasues), Plani V i rregulloreve të sigurisë për motorët e automjeteve: Emetimet e automjeteve (standard 1100), SOR/97-376, (28 korrik, 1997), i ndryshuar herë pas here.

24. Akti i Kanadasë për mbrojtjen e mjedisit, rregulloret e lëndës djegëse dizel, SOR/97-110 (4 shkurt, 1997, sqfuri në lëndët djegëse dizel), i ndryshuar herë pas here.

25. Akti kanadez për mbrojtjen e mjedisit, benzoli në rregulloret e benzinës, SOR/97-493 (6 nëntor, 1997), i ndryshuar herë pas here.

26. Akti kanadez për mbrojtjen e mjedisit, sqfuri në rregulloret e benzinës, Gazeta Kanada, Pjesa II, (4 qershor 1999), i ndryshuar herë pas here.

C. Shtetet e Bashkuara të Amerikës

27. Zbatimi i programit të kontrollit për emetimet e burimeve të lëvizshme për automjetet e lehta, kamionët e lehtë, kamionët e rëndë dhe të lëndëve djegëse në masën që kërkohet nga nenet 202 (a), 202 (g) dhe 202 (h) të aktit të ajrit të pastër, i zbatuar nëpërmjet:

a) Kodi 40 të rregullores federale (CFR) Pjesa 80, nënjësia D - gazolinë e riformuluar;

b) CFR 40 pjesa 86, nënjësia A - dispozita të përgjithshme për rregulloret e emetimeve;

c) CFR 40 pjesa 80, seksioni 80.29 - Kontrollat dhe ndalimet për cilësinë e lëndës djegëse dizel.

ANEKSI IX

MASAT PËR KONTROLLIN E EMETIMEVE TË AMONIAKUT NGA BURIMET BUJQËSORE

1. Palët që i nënshtrohen detyrimeve në nenin 3, paragrafi 8 (a), do të marrin masat e parashtruara në këtë aneks.

2. Çdo palë do të marrë në konsideratë nevojën për reduktimin e humbjeve nga cikli i azotit në tërësi.

A. Kodi këshillimor për praktika të mira bujqësore

3. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit, një palë duhet të krijojë, publikojë dhe shpërndajë një kod këshillimor të praktikës së mirë bujqësore për kontrollin e emetimeve të amoniakut. Kodi do të marrë në konsideratë kushtet specifike brenda territorit të palës dhe do të përfshijë në të dispozita për:

- menaxhimin e azotit, duke marrë parasysh ciklin e azotit në tërësi;

- strategjitë ushqimore të blegtorisë;

- teknikat me emetim të ulët të shpërndarjes së plehut organik;

- sistemet me emetim të ulët të ruajtjes së plehut organik ;

- sistemet me emetim të ulët të strehimit të kafshëve; dhe

- mundësitë për kufizimin e emetimeve të amoniakut nga përdorimi i fertilizuesve mineralë.

Palët duhet t'i japin një titull kodit me qëllim që të shmangin ngatërrimin me kodet e tjerë udhëzues.

B. Urea dhe fertilizuesit karbonate të amonit

4. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit, një palë do të ndërmarrë hapa për të mundësuar kufizim të emetimeve të amoniakut nga përdorimi i fertilizuesve të ngurtë me bazë ureje.

5. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit, një palë do të ndalojë përdorimin e fertilizuesve karbonate të amonit.

C. Përdorimi i plehut organik

6. Çdo palë duhet të sigurojë që janë zbatuar teknikat e përdorimit të shllameve me emetim të ulët (siç renditen në dokumentin udhëzues V të miratuar nga Organi Ekzekutiv në mbledhjen e tij të shtatëmbëdhjetë (vendimi 1999/1) dhe çdo ndryshim në të) që kanë treguar se është arritur zvogëlimi i emetimeve me të paktën 30% në krahasim me referencën e parashikuar në atë dokument

udhëzues, për aq kohë sa pala në fjalë i konsideron ato të zbatueshme, duke marrë në konsideratë tokën lokale dhe kushtet geomorfologjike, llojin e shllamit dhe strukturën e fermave. Afati kohor për zbatimin e këtyre masave do të jetë: 31 dhjetor 2009 për palët me ekonomi në tranzicion dhe 31 dhjetor 2007 për palët e tjera.¹⁾

7. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit, një palë duhet të sigurojë që plehu organik i ngurtë i shpërndarë në një tokë që do të plugohet, do të përfshihet brenda saj jo më pak se 24 orë pas shpërndarjes për aq sa e konsideron këtë masë të zbatueshme, duke marrë parasysh tokën lokale dhe kushtet geomorfologjike dhe strukturën e fermës.

D. Ruajtja e plehut organik

8. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit, një palë do të përdorë për depo të reja shllami për derra të mëdhenj dhe ferma të shpendëve me 2,000 derra në majmëri ose 750 dosa ose 40,000 shpendë, sistemet e ruajtjes me emetime të ulëta apo teknika që kanë treguar se është arritur zvogëlimi i emetimeve me të paktën 40% ose më shumë krahasuar me atë referues (siç është shënuar në dokumentin udhëzues të përmendur në paragrafin 6), ose të tjera sisteme ose teknika me një efikasitet të barasvlefshëm të provuar.¹⁾

9. Për depo të reja shllami për derra të mëdhenj dhe ferma të shpendëve me 2,000 derra në majmëri ose 750 dosa ose 40,000 shpendë, një palë do të arrije zvogëlimin e emetimeve me 40% për aq sa pala konsideron se teknika e nevojshme është teknikisht dhe ekonomikisht e zbatueshme.²⁾ Afati kohor i zbatimit të këtyre masave do të jetë: 31 dhjetor 2009 për palët me ekonomi në tranzicion dhe 31 dhjetor 2007 për të gjitha palët e tjera.²⁾

E. Strehimi i kafshëve

10. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit, një palë do të përdorë, për strehime të reja kafshësh për derra të mëdhenj dhe ferma shpendësh me 2,000 derra në majmëri ose 750 dosa ose 40,000 shpendë, sistemet e strehimit të cilat kanë treguar reduktime të emetimeve me 20% ose më shumë në krahasim me referimin (siç është renditur në dokumentin udhëzues të përmendur në paragrafin 6), ose sisteme të tjera ose teknika me një efikasitet ekuivalent të provuar.²⁾ Zbatimi mund të jetë i kufizuar për arsye të mirëqenies së kafshëve, për shembull në sistemet me bazë kashte për derrat dhe kafaze zogjsh, si edhe sistemet me hapësira të gjera për shpendët.

¹⁾ Shënime. Kur një palë gjykon që mund të përdoren sisteme ose teknika të tjera me një efikasitet ekuivalent të provuar për ruajtjen e plehut organik dhe të strehimit të kafshëve, në mënyrë që të pajtohet me paragrafët 8 dhe 10, ose kur një palë gjykon që ulja e emetimeve nga magazinat e plehrave organike të kërkuara sipas paragrafit 9 nuk janë teknikisht ose ekonomikisht të mundura, do të raportojë dokumentacionin për këtë qëllim në përputhje me nenin 7, paragrafi 1 (a).

²⁾ Për qëllim të këtij aneksi, “një vend me ekonomi në tranzicion” do të thotë një palë që me instrumentet e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit ka bërë një deklaratë që ajo dëshiron të trajtohet si një vend me një ekonomi në tranzicion për qëllime të paragrafit 6 dhe/ose 9 të këtij aneksi.



VENDIM
Nr.781, datë 10.11.2011

**PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “INSTITUTI
KANADEZ I TEKNOLOGJISË”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e shkollës së lartë universitare private “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, Tiranë, në emër të shoqërisë “T.A.L.M.-Albania”, sh.p.k., e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla e lartë universitare private “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, Tiranë të organizohet në dy fakultete:

- a) Fakulteti i Ekonomisë, që ofron programet e studimit të ciklit të parë në:
 - i. Administrim biznesi;
 - ii. Administrim biznesi dhe teknologji informacioni.
- b) Fakulteti i Inxhinierisë, që do të ofrojë programet e studimit, të ciklit të parë, në:
 - i. Inxhinieri softuerike;
 - ii. Inxhinieri industriale.

3. Shkolla e lartë universitare private “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, Tiranë, do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 (tre) vite akademike dhe me realizimin e, së paku, 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë e nivelit të parë “Bachelor” në:

- a) Administrim biznesi;
- b) Administrim biznesi dhe teknologji informacioni;
- c) Inxhinieri softuerike;
- ç) Inxhinieri industriale.

4. Shkolla e lartë universitare private “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, Tiranë, do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ministri e lëshon lejen, pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, Tiranë, duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 24.11.2011
Doli nga shtypi më 25.11.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja Mediaprint
Tiranë, 2011

Çmimi 58 lekë